

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6056  
E martë, 7 korrik 2020  
çmimi 0.40 €

Qeveria kërkon mobilizimin e komunave për luftimin e pandemisë FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", FEHMI MEHMETI FAQE 4-5

## BQK-ja KA MARRË TË GJITHA MASAT E NEVOJSHME PËR TA MBËSHTETUR EKONOMINË

Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka thënë se pandemia Covid-19 ka ndikuar në ndërprerjen e aktivitetit në shumë sektorë të ekonomisë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se një ndër sektorët që është goditur shumë nga Covid-19 është sektori i hotelarisë, restorantet dhe kafiteritë. Mehmeti ka thënë se BQK-ja që nga fillimi i pandemisë ka marrë të gjitha masat e nevojshme për ta mbështetur ekonominë e Kosovës duke përdorur fleksibilitetin rregullativ për ta mundësuar shtyrjen e pagesave të kredive pa kërkuar klasifikim të kredive. Ai ka thënë se sektori bankar i Kosovës ka qenë dhe është në gjendje shumë të mirë për përballuar këtë sfidë dhe për të përkrahur edhe më shumë ekonominë e Kosovës



KRYEMINISTRI I KOSOVËS, AVDULLAH HOTI, DHE PRESIDENTI I SERBISË, ALEKSANDAR VUÇIQ MË 12 KORRIK DO TË TAKOHEN NË BRUKSEL FAQE 3

## DIALOGU KOSOVË - SERBI RIFILLON TË DIELËN



Kosova dhe Serbia të dielën në Bruksel do ta rinisin dialogun për normalizim të marrëdhënieve. Mikpritës i takimit ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, do të jetë për-

faqësuesi i lartë i BE-së, Josep Borrell, në prani të të dërguarit të posaçëm për dialog, Miroslav Lajçak. Pas njoftimit për datën e takimit, ka reaguuar KMDLNJ-ja, e cila e ka ftuar Qeverinë e Kosovës ta pezullojë procesin e bisedimeve me Serbinë

## TAHIRI: ÇDO VËREJTJE RRETH LIGJIT PËR PAGA DO TË MERRET PARASYSH DHE DO TË TRAJTOHET FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijibiznesi.com](http://www.kolegijibiznesi.com)  
info@kolegijibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

### AKTUALE



BEKIM HAXHIU KËRKON TË MIRATOHET LIGJI KUNDËR COVID-19 F. 2

HAXHI SHALA LË NISMËN KALON NË AAK F. 5

NË QKUK PO TRAJTOHEN 144 PACIENTË ME COVID-19 F. 6

AGRON BAJRAKTARI RIZGJEDHET REKTOR I UNIVERSITETIT TË SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ F. 6

### EKONOMI



RUKIQI: NËSE NUK KA VEPRIME TË SHPEJTA, RREZIKOHEN TË MBYLLEN MIJËRA BIZNESE F. 9

ODA EKONOMIKE AMERIKANE FTON BIZNESET TË ZBATOJNË MASAT PËR PARANDALIMIN E PANDEMISË COVID-19 F. 8

### EKONOMI

REXHA: DUA TITULLIN DHE 'KËPUCËN E ARTË' F. 16

# Bekim Haxhiu kërkon të miratohet ligji kundër Covid-19

**EPOKA E RE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 6 KORRIK - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka kritikuar qeverinë aktuale për keqmenaxhimin e situatës me pandemi, duke kërkuar që sa më parë të miratohet ligji kundër Covid-19.

Deputeti i kësaj partie, Bekim Haxhiu, në një konferencë për media ka thënë se qeveria aktuale po i bën gabimet e ish-qeverisë, duke mos marrë masa të duhura dhe menaxhuar më mirë këtë pandemi. "Situata me Covid-19 në Kosovë është e rëndë. Vetëm brenda 48 orëve të fundit janë regjistruar 330 raste pozitive dhe 17 raste të vdekjes me Covid-19. Ne emër timin dhe të PDK-së u shprehim ngushëllime më të sinqerta familjarëve për më të dashurit e tyre. Po ashtu, kërkojmë që asnjë rast të mos paragjykohet dhe t'u

japim mundësi dhe kohë hetimeve që ta thonë fjalën e tyre. Nuk duhet të humbasim më shumë kohë për ta miratuar Ligjin anti Covid-19, i cili, sipas PDK-së, do të duhej të fokusohet në tri masa kryesore. E para, ta rregullojë vendosjen e masave për çdo sektor dhe penalizimin në detaje për çdo mosrespektim. Kjo nënkupton masa të rrepta që përfshin mobilizim dhe bashkërendim të aktiviteteve mes institucioneve qendrore, administratës, komunave, inspektorëve e policisë, në mënyrë të kontrolluar 24 orë në betejën kundër pandemisë. Së dyti, gabimet e ish-qeverisë Kurti në menaxhimin e pandemisë po vazhdojnë edhe nga qeveria e re", ka thënë Haxhiu, duke shtuar se, fatkeqësisht, nuk janë dëgjuar thirrjet e përsëritura të PDK-së që nga fillimi që të rritet numri i testeve në nivel të Kosovës



dhe të decentralizohet edhe në komuna. "Kosova ka kapacitete të paktën të bëjë teste deri në

1 000 në ditë. Është e dhimbshme të dëgjosh çdo ditë qytetarët që nuk arrijnë të bëjnë

teste në Kosovë dhe detyrohen të shkojnë në vendet fqinje", ka thënë deputeti Haxhiu.

# Presidenti Meta kërkon strategji të re për Covid-19

TIRANË, 6 KORRIK - Ministria e Shëndetësisë në Shqipëri raportoi të hënën për vdekjen e tre pacientëve të tjerë me Covid-19.

Eugena Tomini nga Instituti i Shëndetit Publik tha në një konferencë për media se viktimat ishin të moshave 63, 65 dhe 69 vjeç nga Tirana, Lezha dhe Puka. Ajo bëri me dije se në mesin e atyre që humbën jetën nga koronavirusi ishte edhe mjeku Hysni Shjaku.

Prej rreth një jave autoritetet shëndetësore në Shqipëri raportojnë mesatarisht për 2-3 viktima në ditë. Prej fillimit të muajit qershor kanë vdekur 46 persona, 13 më shumë se periudha tremujore mars-maj. "Vazhdon të ketë shtrime në Spitalin Infektiv, ku aktualisht janë 78 pacientë në spital, prej të



cilëve 9 në gjendje serioze, 2 prej tyre të intubuar në gjendje të

rëndë", u shpreh Tomini. Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta,

në një konferencë për media u shpreh i shqetësuar për situatën

në vend dhe i bëri thirrje qeverisë për një strategji të re për luftimin dhe përballimin e pandemisë pas rritjes së numrit të viktimave. Ai kërkoj që të ketë masa mbrojtëse më të larta për mjekët e infermierët që po luftojnë me virusin.

Ministria e Shëndetësisë njoftoi se gjatë 24 orëve të fundit ishin kryer 459 teste, prej të cilave 71 persona u diagnostikuan me Covid-19, duke e çuar totalin në 2 964 të prekur prej kur ka filluar përhapja e pandemisë në vend. Që nga muaji mars e deri më sot, autoritetet shëndetësore kanë kryer rreth 30 mijë teste, prej të cilëve 2 964 kanë rezultuar të infektuar (10 për qind e të testuarve), 1 702 kanë mundur të shërohen, 79 kanë vdekur, ndërsa 1 183 persona janë aktivë.

# Osmani bashkëbisedoi me Zyrën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë në Kosovë



PRISHTINË, 6 KORRIK (ER) - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka zhvilluar të hënën një bisedë virtuale me përfaqësuesit e Zyrës së Organizatës Botërore të Shëndetësisë në Kosovë, Sergei Koryak dhe Isme Humolli. Në takim u bisedua për nevojën e vazhdimit të bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe OBSH-së në përpjekje për menaxhim të suk-

sesshëm të pandemisë Covid-19.

Kryetarja Osmani i ka njoftuar zyrtarët e OBSH-së në lidhje me iniciativën ligjore të ndërmarrë me qëllim që vendimet për masat anti Covid të kenë bazë ligjore, teksa organet e rendit ta kenë mundësinë e veprimit aty ku hasen shkelje.

Gjithashtu, në këtë takim u potencua rritja e fokusit ndaj

sektorit të shëndetësisë, ngase pandemia nuk ka përfunduar, ndaj veprimet e vonuara mund të shkaktojnë efekt zinxhiror dhe dëme më të mëdha.

Palët diskutuan edhe për rëndësinë e shembullit që duhet të paraqesin liderët institucionalë, duke respektuar masat mbrojtëse, për të ndërtuar një normë të re të sjelljes në kohë pandemie.

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, më 12 korrik do të takohen në Bruksel

# Dialogu Kosovë - Serbi rifillon të dielën

Kosova dhe Serbia do ta rinisin dialogun për normalizim të marrëdhënieve në Bruksel të dielën. Mikpritës i takimit ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, do të jetë përfaqësuesi i lartë i BE-së, Josep Borrell, në prani të të dërguarit të posaçëm për dialog, Miroslav Lajçak. Pas njoftimit për datën e takimit, ka reaguar KMDLNj-ja, e cila e ka ftuar Qeverinë e Kosovës ta pezullojë procesin e bisedimeve me Serbinë



pezullojë bisedimet me Serbinë deri në një kohë tjetër përkundër insistimit të Francës dhe Gjermanisë, në emër të BE-së e cila, së paku deri më tani, është treguar e padrejtë ndaj qytetarëve të Kosovës duke ua pamundësuar lirinë e lëvizjes. Kosova aktualisht po përballet me probleme shumë më të rëndësishme sesa që kanë bisedimet me një shtet armiqësor siç është Serbia; lufta kundër pandemisë së shkaktuar nga Covid-19 dhe varfërimi i skajshëm i pjesës dërrmuese të qytetarëve të saj”, ka vlerësuar KMDLNj.

## Hoti të martën takohet me Macronin

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, të martën do të takohet në Paris me presidentin e Francës, Emmanuel Macron. Qeveria përmes një njoftimi ka njoftuar se kryeministri të hënën ka udhëtuar për në Paris. “Pritja zyrtare që bëhet enkas për kryeministrin e Republikës së Kosovës në Pallatin Elize (Palais de l’Elysée) në Paris, Pallati Presidencial i Francës, tregon kujdesin dhe përkushtimin e presidentit Macron ndaj Kosovës dhe të ardhmes së saj euroatlantike”, ka njoftuar Qeveria e Kosovës.

qartazi se dikush nga ata që janë vendimmarrës në aspektin global nuk ka qenë i interesuar që të vazhdojnë bisedimet në përbërjen e mëparshme. Goditja nga Gjykata Speciale kishte një porosi dhe qëllim shumë politik dhe fare pak juridik; imponimi i vazhdimit të bisedimeve për Kosovën në kushte krejtësisht të pabarabarta dhe favorizimi i Serbisë kur ajo ka ekip përfaqësues të nivelit më të

lartë e që Kosova nuk e ka. U bë mirë që kryeministri Hoti nuk shkoi në Uashington. Do të bënte edhe më mirë të mos shkonte as në Paris sepse, me një ekip të cunguar negociues, nuk do të kishte as kredibilitet dhe as të drejtë”, ka vlerësuar KMDLNj-ja në një komunikatë për media.

Ky këshill ka vlerësuar se Kosova tani po përballet me probleme shumë me të rëndësishme sesa dialogun me Serbinë. “Kosova duhet t’i

Sipas KMDLNj-së, qeveria aktuale ka mungesë të madhe të kapacitetit negociues sikur që është shumë e brishtë për shkak të numrave dhe përbërjes në aspektin e qëndrueshmërisë. “Prandaj nuk e bën aspak të besueshme në procesin negociues, aq më parë që po përballet me probleme të mëdha me menaxhimin e pandemisë, ku situata vetëm është përshkallëzuar. Nëse nuk sigurohet një qeveri me përfaqësim të gjerë, ku opozita do ta kishte vendin e merituar në përputhje me fuqinë e votës, atëherë duhet të mendohet seriozisht për zgjedhje të reja. Kjo qeveri, me këtë forcë të votës që nuk e ka, as nuk duhet të bisedojë e lëre më të marrë vendime për një marrëveshje të madhe me Serbinë kur Kosova, falë rrethanave të imponuara, është në një defansivë të plotë”, është thënë në njoftimin e KMDLNj-së.

EPOKA ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 6 KORRIK - Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian (BE) do të rinisë më 12 korrik.

Zëdhënësi i Bashkimit Evropian, Peter Stano, ka konfirmuar të hënën se kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, do të takohen në raundin e ri të bisedimeve. “Mund të konfirmoj se më 12 korrik, kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, do të vijnë në Bruksel për dialog. Mikpritës i këtij samiti do të jetë përfaqësuesi i lartë i BE-së, Josep Borrell, në prani të të dërguarit të posaçëm për dialog, Miroslav Lajçak”, ka thka thënë ai.

Stano ka vlerësuar se me këtë takim shënohet rifillimi i dialogut për normalizimin e raporteve mes Kosovës dhe Serbisë dhe në të do të

diskutohen “të gjithë çështjet e hapura”. Dy ditë më parë, më 10 korrik, do të zhvillohet një “samiti virtual” mes liderëve të Kosovës dhe Serbisë, që do të ndërmjetësohet nga presidenti i Francës, Emmanuel Macron dhe kancelarja gjermane, Angela Merkel.

Ndonëse Qeveria e Kosovës është shprehur e gatshme për vazhdimin e këtij procesi, qoftë në Uashington apo në Bruksel, në Kosovë ka zëra që kanë kërkuar pezullimin e këtij procesi.

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka vlerësuar se pezullimi i këtyre bisedimeve duhet të ndodhë për shkak të bërjes publike të propozimatakuzës nga Gjykata Speciale për presidentin Hashim Thaçi dhe liderin e PDK-së, Kadri Veseli. Sipas KMDLNj-së, kjo paraqet shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut ndaj presidentit Hashim Thaçi dhe ish-kryetarit të Kuvendit si dhe liderit të PDK-së, Kadri Veseli. “Duket

## Tahiri: Çdo vërejtje rreth Ligjit për paga do të merret parasysh dhe do të trajtohet



PRISHTINË, 6 KORRIK (ER) - Zëvendëskryeministri i parë, Besnik Tahiri, në një konferencë për media mbajtur të hënën, ka folur për Ligjin për paga. Ai ka thënë se aty ku Kushtetuesja ka sugjeruar për korrigjim do të veprojnë në të gjitha kategoritë dhe ku rekomandohet për largim të dispozitave do të veprojnë. “Javën e kaluar unë jam zotuar se do të fillojmë me Ligjin e Pagave, ku zhvillova një takim me katër shtyllat kryesore të punëtorëve të sektorit publik. Theksova se nga Gjykata Kushtetuese nuk kemi një vendim, por kemi një njoftim nga ajo, të cilin e kemi anal-

izuar. Andaj, garantova se çdo vërejtje do të merret parasysh dhe do të trajtohet”, ka thënë Tahiri. Ai ka shtuar se çkado që nuk kontestohet si çështje nga Kushtetuesja, do të trajtohet si e tillë dhe do të mbetet. “Aty ku janë dhënë rekomandime eksplicite për korrigjime, ne do t’i nisim punët që t’i inkorporojmë ato dhe çfarëdo që sugjerohet të hiqet nga ligji, ajo do të ndodhë. Po ashtu, theksova se, porsa ta marrim vendimin nga Kushtetuesja, do ta bëjmë publik grupin punues nga ministria që do ta trajtojë këtë temë”, ka deklaruar Tahiri.

FLET PËR "EPOKËN E RE", FEHMI MEHMETI

# BQK-ja KA MARRË TË GJITHA MASAT E NEV



Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka thënë se pandemia Covid-19 ka ndikuar në ndërprerjen e aktivitetit në shumë sektorë të ekonomisë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se një ndër sektorët që është goditur shumë nga Covid-19 është sektori i hotelarisë, restorantet dhe kafiteritë. Mehmeti ka thënë se BQK-ja që nga fillimi i pandemisë ka marrë të gjitha masat e nevojshme për ta mbështetur ekonominë e Kosovës duke përdorur fleksibilitetin rregullativ për ta mundësuar shtyrjen e pagesave të kredive pa kërkuar klasifikim të kredive. Ai ka thënë se sektori bankar i Kosovës ka qenë dhe është në gjendje shumë të mirë për ta përballuar këtë sfidë dhe për ta përkrahur edhe më shumë ekonominë e Kosovës

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 KORRIK - "Epoka e re": Z. Mehmeti, në çfarë gjendje e solli pandemia Covid-19 ekonominë e Kosovës? Mund të na flisni për sektorët më të sulmuar?

**Mehmeti:** Pandemia Covid-19 ka ndikuar në ndërprerjen e aktivitetit në shumë sektorë të ekonomisë, duke lënë bizneset pa të hyra, përdërisa detyrimet e këtyre bizneseve vazhdojnë të jenë aktive, që rrezikon aftësinë e tyre paguese dhe mund t'i shtyjë ato edhe drejt dështimit. Një ndër sektorët që është goditur shumë nga

pandemia Covid-19 është sektori i hotelarisë, restorantet dhe kafiteritë (HORECA), i cili pritet që ta ketë më të vështirë rimëkëmbjen në muajt në vijim. Vështirësitë në këtë sektor do të ndikojnë dukshëm edhe në rënien e kërkesës agregatë. Gjithashtu, janë prekur edhe remitencat, të cilat gjatë periudhës janar-prill 2020 në Kosovë kanë arritur vlerën e 247.61 milionë euro. Kjo shifër paraqet 5.8 milionë euro më pak se periudha e njëjtë e vitit të kaluar. Gjithashtu, me gjithë kthimin pozitiv të investimeve të bëra nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, deri më

## Haxhi Shala e lë Nismën, kalon në AAK

PRISHTINË, 6 KORRIK (ER) - Deputeti i Nismës Socialdemokrate, Haxhi Shala, të hënën është bërë pjesë e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Shalën e ka pritur në selinë e AAK-së kryetari Ramush Haradinaj. "Sot pata nderin që me z. Haxhi Shala,

deputet në Kuvendin e Kosovës, të vendosim të rrugëtojmë së bashku në Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës. Vendosëm që bashkërisht t'u shërbejmë interesave të vendit në këto kohë të ndjeshme dhe në të gjitha etapat e radhës. Jam mirënjohës për deputetin Shala,

tash kolegë në Aleancë, për angazhimin e tij në proceset e deritashme të rëndësishme për vendin tonë, si dhe për vendimin që së bashku me bashkëpunëtorët e tjerë ta vazhdojnë rrugëtimin politik në AAK", ka thënë Haradinaj me rastin e aderimit të Haxhi Shalës në AAK.



# OJSHME PËR TA MBËSHTETUR EKONOMINË



potenciale në të hyrat nga jashtë, si dhe ndikimi i masave të ndërmarra të mbylljes dhe karantinimit nga marsi i vitit 2020 për ta parandaluar përhapjen e shpejtë potenciale të epidemisë në vend, sipas BQK-së, do të rezultojnë në tkurrje të aktivitetit ekonomik veçanërisht në muajt prill dhe maj. Për vitin 2020, parashikimet e BQK-së sugjerojnë se norma reale e rënies së BPV-së pritet të jetë rreth 5.9 për qind.

**“Epoka e re”:** Kërkesat më të mëdha nga klientët mbesin për shtyrje të kistiti të kredive. A do të ketë shtyrje të sërishme?

**Mehmeti:** Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është treguar proaktive në ndërmarrjen e masave për t’u ndihmuar huamarrësve përbashkët të BQK-së dhe të ShBK-së. Zbatimi i këtij vendimi të përbashkët do të jetë subjekt i ekzaminimit të BQK-së pas kalimit të situatës në të cilën ndodhemi dhe varësisht nga rezultatet e ekzaminimeve, do t’i ndërmarrim masat administrative/ndëshkuese, të parapara me legjislacionin në fuqi.

Sidoqoftë, ne do të vazhdojmë së monitoruari me shumë kujdes zhvillimet ekonomike dhe ato në sektorin financiar, në mënyrë që ta japim kontributin tonë të mëtejme në rimëkëmbjen e ekonomisë, por gjithmonë duke vendosur në plan të parë ruajtjen e stabilitetit financiar që është edhe detyra primare e BQK-së.

**“Epoka e re”:** Po ashtu, ka pasur ankesa të shumta ndaj bankave komerciale për mospërfillje të rregullores së BQK-së, gjegjësisht standarde të dyfishta për shtyrje të kësteve, a keni marrë ndonjë maskë ndaj bankave komerciale?

**Mehmeti:** Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka informuar bankat lidhur me vendimin e përbashkët të BQK-së dhe të ShBK-së. Zbatimi i këtij vendimi të përbashkët do të jetë subjekt i ekzaminimit të BQK-së pas kalimit të situatës në të cilën ndodhemi dhe varësisht nga rezultatet e ekzaminimeve, do t’i ndërmarrim masat administrative/ndëshkuese, të parapara me legjislacionin në fuqi.

**“Epoka e re”:** Sa është numri i ankesave në BQK ndaj bankave komerciale?

**Mehmeti:** Nga data 1 janar 2020 deri më 23 qershor 2020 BQK-ja ka pranuar 610 ankesa, prej të cilave 522 janë vetëm gjatë periudhës 12 mars 2020 deri më 23 qershor 2020.

**“Epoka e re”:** Ku ka mbetur çështja e rregullimit me Institucionet Financiare Jobankare, e kam fjalën sa i përket veprimit të tyre si OJQ?

**Mehmeti:** Banka Qendrore e Republikës së Kosovës merret me regjistrimin/licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të ndërmjetësimit financiar që bëjnë këto institucione mikrofinanciare, ndërsa çështjet e lidhura me

aktivitetin dhe statusin e tyre si OJQ nuk bëjnë pjesë në fushëveprimin e BQK-së pasi që BQK-ja i mbikëqyrë dhe i rregullon aktivitetet e tyre financiare e jo statusin ligjor të tyre.

**“Epoka e re”:** Çfarë risish pritet ta karakterizojnë sektorin financiar pas pandemisë? A do të kemi rënie të normave të interesit dhe a ka kërkesa për operim të ndonjë banke tjetër në Kosovë?

**Mehmeti:** Sektori bankar ka një rol shumë të rëndësishëm në minimizimin e pasojave negative makroekonomike të shkaktuara nga pandemia e paprecedentë që tashmë ka përfshirë pothuajse të gjitha vendet. Sektori bankar duhet t’i mbështesë huamarrësit e dëmtuar duke vazhduar kreditimin e ekonomisë dhe në të njëjtën kohë duhet ta ruajë stabilitetin financiar. Siç edhe e kam thënë edhe më herët, sektori bankar i Kosovës ka qenë dhe është në gjendje shumë të mirë për ta përbashkuar këtë sfidë dhe për të përkrahur edhe më shumë ekonominë e Kosovës. BQK-ja që nga fillimi i pandemisë ka marrë të gjitha masat e nevojshme për ta mbështetur ekonominë e Kosovës duke përdorur fleksibilitetin rregullativ për të mundësuar shtyrjen e pagesave të kredive pa kërkuar klasifikim të kredive. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme përbëjnë pjesën më të madhe të bizneseve në Kosovë. Në të gjitha ekonomitë ato luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik duke përmirësuar shpërndarjen e të ardhurave, krijimin e vendeve të punës dhe rritjen e eksportit. Lehtësimi i qasjes në financim nga institucionet kredidhënëse për këtë kategori të ndërmarrjeve është shumë i rëndësishëm pasi që financimi nga burimet e tjera është i kufizuar. Suksesi i këtyre ndërmarrjeve dhe në të njëjtën

kohë suksesi i ekonomisë së Kosovës varet nga qasja e tyre në financa dhe mbështetja financiare nga qeveria. Fondi Kosovar për Garanci Kreditore është një nga aktorët kyç në lehtësimin e qasjes në financa. Rritja e mbulueshmërisë së kredive të reja përmes këtij fondi do ta stimulojë rritjen e kredive qoftë përmes rritjes së kërkesës pasi që lehtëson qasjen në financa qoftë përmes rritjes së ofertës pasi që bankat do të jenë më pak të ekspozuara ndaj rrezikut kreditor. Në të njëjtën kohë, me qëllim të stimulimit të rritjes së kreditimit, BQK-ja do t’i lehtësojë kërkesat për mjaftueshmëri të kapitalit duke peshuar me rrezik më të ulët të gjitha kreditë ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Ky zvogëlim në peshën e rrezikut të këtyre kredive do të jetë në harmoni me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe nuk do ta rrezikojë stabilitetin financiar. Gjithashtu, kreditë e siguruara me patundshmëri komerciale do të merren parasysh për t’u peshuar me rrezik më të ulët. Këto lehtësime do t’u mundësojnë bankave që ta rrisin kreditimin në këto dy kategori të kredive. Sa i përket zvogëlimit të kërkesave për likuiditet, aktualisht bankat kanë nivele të larta të likuiditetit dhe nuk kanë pengesë në këtë drejtim për ta kredituar ekonominë. Në rast se në të ardhmen bankat do të kenë kufizime apo vështirësi në likuiditet, BQK-ja përkohësisht do ta përdorë fleksibilitetin rregullativ duke zvogëluar rezervën minimale dhe kërkesat e tjera për nivele të likuiditetit. BQK-ja ka qenë vazhdimisht në kontakt me të gjitha bankat për t’i diskutuar sfidat aktuale dhe ato në të ardhmen. Bankat në Kosovë kanë mundësi dhe janë të gatshme që të ndihmojnë në realizimin e masës një dhe tetë të planit për rimëkëmbje ekonomike.

29 maj 2020 humbjet arritën në 28 milionë euro. Sektori i sigurimeve gjithashtu ka qenë i ndikuar nga pandemia Covid-19, meqë gjatë pandemisë kishte rënie të shitjes së policave të sigurimit. Në 4 muajt e parë të vitit 2020, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, numri i policave të sigurimit kishte rënie për 28 mijë, pra nga 131 mijë në 103 mijë apo 21.5 për qind më pak.

**“Epoka e re”:** Sa pritet të jetë rënia ekonomike si pasojë e Covid-19?

**Mehmeti:** Rritja e rreziqeve nga ekonomia e jashtme dhe rënia

## Shkarkohet drejtori i ShSKUK-së, Basri Sejdiu, ushtrues detyre caktohet Valbon Krasniqi

PRISHTINË, 6 KORRIK (ER) - Bordi Drejtues i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK) ka shkarkuar drejtorin e përgjithshëm të këtij institucioni, Basri Sejdiu. Ushtrues detyre në këtë pozitë është emëruar infektologu Valbon Krasniqi. “Bordi

Drejtuës i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës njofton se në mbledhjen e mbajtur sot, më 6 korrik 2020, ka marrë vendim ta shkarkojë nga detyra dr. Basri Sejdiu, drejtor i përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës.

Shkarkimi vjen si pasojë e performancës jo të kënaqshme dhe mospërmblidhjes së detyrave të punës. Në vend të dr. Sejdiut, ushtrues detyre i drejtorit është caktuar dr. Valbon Krasniqi, mjek specialist i infektologjisë”, ka njoftuar Bordin Drejtues i ShSKUK-së.



# UNDP-ja sjell edhe 20 ventilatorë për Kosovën kundër pandemisë

**EPOKA E RE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 6 KORRIK - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë, si reagim i menjëhershëm ndaj Covid-19, ia ka dorëzuar ngarkesën e dytë me 20 ventilatorë mobil Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Këta ventilatorë janë blerë me fonde të qeverive të Norvegjisë, Zvicrës dhe Luksemburgut. Ventilatorët do ta ngritin kapacitetin e kujdesit intensiv të sektorit shëndetësor të Kosovës.

Për shkak të situatës aktuale kritike, ventilatorët u dërguan menjëherë në QKUK sapo arritën në Kosovë.

Përfaqësuesja e përhershme e UNDP-së, Maria Suokko, ka thënë se që nga mesi i muajit mars UNDP-ja në Kosovë e ka vendosur luftën kundër pandemisë Covid-19 në ballë të të gjitha përpjekjeve, duke iu përgjigjur nevojave më urgjente dhe duke mbështetur rimëkëmbjen më afatgjatë. "Falënderojmë Qeveritë e Norvegjisë, Zvicrës dhe Luksemburgut për kontributet e tyre bujare që na kanë lejuar të blejmë këto pajisje që ndihmojnë në shpëtimin e



jetëve. Ne do të vazhdojmë të ofrojmë gjithë ekspertizën dhe kapacitetet tona për të vazhduar

të punojmë ngushtë me partnerët tanë për ta mbështetur popullin dhe

institucionet në Kosovë në kohë krize dhe përtej", ka thënë Suokko.

Ulrika Richardson, koordinatore për Zhvillimin e OKB-së, ka deklaruar se ekipi i OKB-së në Kosovë ka punuar së bashku me institucionet dhe njerëzit për t'i lehtësuar efektet e Covid-19. "Ne u jemi mirënjohës donatorëve dhe partnerëve kryesorë të OKB-së për kontributin e dhënë enkas, që na ka mundësuar të sjellim pajisje dhe artikuj shëndetësorë për shpëtimin e jetëve në Kosovë. Ndërsa mbështetja jonë forcon sistemet, qasja jonë i vë gjithmonë njerëzit në qendër me respektimin e të drejtave të njeriut, barazisë dhe gjithëpërfshirjes. Kosova do ta tejkalojë këtë krizë, por kërkohet një qasje e integruar ndaj veprimeve dhe masave emergjente dhe afatgjatë që mundëson bashkërenditjen e institucioneve, bizneseve dhe popullatës", ka thënë Richardson.

Ambasadori i Norvegjisë në Kosovë, Jens Erik Grondahl, ka theksuar se Norvegjia është krenare të vazhdojë t'i mbështesë përpjekjet e Qeverisë së Kosovës kundër pandemisë Covid-19 me sigurimin e ventilatorëve që nevojiten

urgjentisht për spitalet.

Edhe ambasadori i Zvicrës në Kosovë, Jean-Hubert Lebet, ka thënë se është i lumtur që u bë dorëzimi i ngarkesës së dytë të këtyre pajisjeve të rëndësishme për ta luftuar Covid-19. "Kjo do ta rrisë kapacitetin e sistemit të brishtë shëndetësor për t'u përballur me numrin e shtuar të të shtrirëve", ka deklaruar ai. Natacha Gomes, e ngarkuara me punë në Ambasadën e Dukatës së Madhe të Luksemburgut, ka thënë se Luksemburgu vazhdon ta mbështesë Kosovën në këtë kohë të vështirë dhe, sipas saj, këta ventilatorë arrijnë në një moment kyç kur shohim një rishfaqje të lartë të infeksioneve së bashku me rritjen e nivelit të sëmundjes, duke i dhënë një tendosje sistemit të brishtë shëndetësor.

Kontributi i përgjithshëm nga qeveria e Norvegjisë, e Zvicrës dhe e Luksemburgut për blerjen e ventilatorëve mobilë Vg70 është 1,17 milion dollar, në partneritet me UNDP-në. Falë kësaj mbështetjeje bujare UNDP-ja ka blerë 40 ventilatorë. Ngarkesa e parë prej 20 ventilatorësh është dorëzuar më 12 qershor dhe 20 ventilatorët e tjerë janë dorëzuar të shtunën, më 4 korrik.

## Agron Bajraktari rizgjedhet rektor i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj

FERIZAJ, 6 KORRIK (ER) - Këshilli Drejtues i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) ka intervistuar të hënën kandidatët për rektor të Universitetit dhe me shumicë votash ka zgjedhur prof. dr. Agron Bajraktari.

Bajraktari është rizgjedhur rektor edhe për një mandat katërvjeçar në një konkurrencë prej pesë kandidatëve, të cilët kishin aplikuar në bazë të konkursit të

shpallur më 10.06.2020 për zgjedhjen e rektorit të UShAF.

Rektori Bajraktari ka udhëhequr UShAF në katër vjetët e kaluar, pra që nga themelimi i këtij universiteti dhe kontributi i tij ka qenë i jashtëzakonshëm në zhvillimin e universitetit të vetëm të shkencave të aplikuara në Kosovë.

UShAF-i me këtë rast ka mbyllur procesin e zgjedhjeve në universitet.



## Në QKUK po trajtohen 144 pacientë me Covid-19

PRISHTINË, 6 KORRIK (ER) - Sipas raportit 24 orësh nga Klinika Infektive, Klinika e Pulmologjisë dhe njësia intensive në Mjekësi Sportive, në trajtim kanë gjithsej 144 pacientë të konfirmuar

me Covid-19 pozitiv. Në Klinikën Infektive ka 111 raste, në Intensivë të Mjekësisë Sportive nëntë raste, prej tyre, dy të intubuar, kurse në Klinikën e Pulmologjisë janë të

shtrirë 24 raste të konfirmuara me Covid-19 pozitiv.

Në Klinikën Infektive, nga 111 rastet, 55 raste janë duke u trajtuar në reparte me oksigjenoterapi dhe përkujdesje

intensive.

Në repartin e Mjekimit Intensiv janë duke u trajtuar dy raste në gjendje të rëndë me oksigjenoterapi dhe përkujdesje intensive.

KOMUNAT INFORMOHEN ME MASAT E REJA TË QEVERISË NDAJ PANDEMISË COVID-19

# Qeveria kërkon mobilizimin e komunave për luftimin e pandemisë

Qeveria e Kosovës ka kërkuar mobilizimin e komunave për luftimin e pandemisë Covid-19. Në një bashkëbisedim në formë elektronike me Asociacionin e Komunave të Kosovës, kryeministri Avdullah Hoti ka kërkuar nga kryetarët e komunave t'i ndërmarrin hapat e nevojshëm për riaktivizimin e shtabeve emergjente komunale për menaxhimin e pandemisë Covid-19. Ai është zotuar se qeveria do ta sigurojë ndarjen e buxhetit për angazhimin e personelit shëndetësor shtesë



**Zemaj kërkon zbatim të menjëhershëm të masave të reja**

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka kërkuar nga institucionet përgjegjëse në vend që t'i zbatojnë me përgjegjësinë më të lartë vendimet e marra në mbledhjen e fundit të qeverisë, të cilat kanë hyrë në fuqi të hënën. "Secili institucion ta japë maksimumin, pavarësisht se e kuptojmë që zgjatja e kësaj situatë ka krijuar edhe lodhje dhe ngarkesa më të mëdha, por është situatë emergjente e shëndetit publik dhe duhet të sillemi me shumë përgjegjësi", ka deklaruar ministri Zemaj në takimin e Komitetit për Vlerësimin dhe Koordinimin e situatës për Covid-19.

Ai ka thënë se konform vendimeve të qeverisë nga sot ka filluar riorganizimi i kapaciteteve spitalore dhe shtimi i shtretërve, fuqizimi i personelit me profesionistët e rekrutuar nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, në mënyrë specifike në degët si mikrobiologjia, infektologjia dhe shërbimet e tjera të ndërlidhura me rastet e Covid-19, ndërkohë që gjatë javës MSh-ja do t'i prezantojë për miratim qeverisë edhe Planin e Veprimit për procedurat e testimit për Covid-19 në Kosovë.

Ai ka kërkuar nga inspektoratet dhe autoritetet e tjera relevante që t'i monitorojnë dhe zbatojnë vendimet lidhur me kufizimet e qarkullimit në katër komunat e Kosovës: Prishtinë, Ferizaj, Prizren e Vushtrri sikurse edhe sektorin e gastronomisë për të cilin janë vënë kufizime në nivel vendi.

Zemaj ka deklaruar se monitorimi duhet të bëhet edhe në komunat e tjera, duke shtuar se kufizime mund të vendosen edhe në komuna të tjera, apo të hiqen varësisht prej situatës epidemiologjike në vend lidhur me Covid-19.

Në këtë takim është kërkuar që secili institucion të raportojë brenda javës për zbatimin e vendimeve të fundit të qeverisë lidhur me masat kundër Covid-19.

Duke iu përgjigjur pyetjeve dhe shqetësimeve të kryetarëve të komunave të Kosovës, të cilat kryesisht ndërlidheshin me përgjegjësitë dhe autorizimet e inspektorateve sanitare dhe me numrin e pamjaftueshëm të inspektorëve komunalë sanitarë, kryeministri ka deklaruar se komunat mund të angazhojnë, sipas nevojave të tyre, inspektorë shtesë, të cilët duhet t'i ndërmarrin të gjitha masat e parapara ndaj personave fizikë dhe juridikë, duke përfshirë edhe shqiptimin e gjobave sipas kompetencave që ua japin ligjet në fuqi.

Sa i përket rifillimit të procesit mësimor në institucionet shkollore, në muajin shtator

kryeministri ka treguar se Qeveria e Kosovës do t'u përmbahet protokollove të OBSH-së dhe me kohë do të dalë me qëndrim për këtë çështje. Gjatë këtij bashkëbisedimi shumica e kryetarëve të komunave kanë shtruar si shqetësim procedurat e testimit për Covid-19, ndërsa kryeministri Hoti i ka njoftuar ata se qeveria, nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, do ta mundësojë decentralizimin e këtij procesi nëpërmjet licencimit të institucioneve private shëndetësore për të kryer teste për Covid-19, në përputhje me ligjet në fuqi.

## IKD-ja kërkon urgjentisht miratimin e Ligjit kundër Covid-19

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka reaguar për qasjen e institucioneve për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19. Përmes një komunikate për media IKD-ja ka vlerësuar se qasja e qeverisë Hoti ndaj pandemisë është kundërkushtuese, duke kërkuar që urgjentisht të miratohet Ligji kundër Covid-19. "Që nga shpallja e kësaj pandemie nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, institucionet në Kosovë kanë dështuar në miratimin e

kornizës ligjore adekuate, duke ndikuar që menaxhimi i kësaj pandemie të bëhet duke shkelur vazhdimisht dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe duke cenuar rëndë të drejtat dhe liritë e njeriut në Kosovë. Për nevojën e kësaj qasje, IKD-ja vazhdimisht ka alarmuar ish-qeverinë Kurti, duke i bërë thirrje për shkeljet kushtetuese të vendimeve të domosdoshme anti Covid-19, të cilat shkelje ishin vërtetuar edhe nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 6 KORRIK** - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka kërkuar të hënën nga komunat mobilizim për luftimin e pandemisë Covid-19. Në një bashkëbisedim në formë elektronike me Asociacionin e Komunave të Kosovës, gjatë të cilit u janë prezantuar kryetarëve të komunave të Kosovës masat e reja që janë ndërmarrë me qëllim të parandalimit dhe menaxhimit të pandemisë Covid-19, Hoti ka kërkuar që ata t'i ndërmarrin hapat e nevojshëm për riaktivizimin e shtabeve emergjente komunale për menaxhimin e pandemisë Covid-19.

Kryeministri Hoti ka marrë përkrahjen e plotë nga kryetarët e komunave për masat që ka marrë Qeveria e Kosovës pas shtimit të rasteve të infektuarve me Covid-19, të cilët kanë theksuar gatishmërinë e plotë të tyre për t'i bashkënduar të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që situata e krijuar të përballohet sa më mirë. "Kemi paraparë mobilizimin e stafit

shëndetësor në nivel vendi, duke përfshirë, sipas nevojave, edhe ata profesionistë shëndetësorë, që nuk janë të angazhuar momentalisht. Në veçanti do të shtohen kapacitetet në shërbimin e mikrobiologjisë, infektologjisë dhe shërbimeve të tjera të lidhura drejtpërdrejt me rastet Covid-19", ka thënë Hoti.

Ai ka theksuar se qeveria do ta sigurojë ndarjen e buxhetit për angazhimin e personelit shëndetësor shtesë dhe për pajisjet mbrojtëse të personelit shëndetësor. "Nga data 6 korrik 2020, duke filluar nga ora 21:00 deri në orën 05:00, kemi ndaluar çfarëdo qarkullimi të personave fizikë jashtë shtëpive/banesave të tyre në Prishtinë, Ferizaj, Prizren dhe Vushtrri, përveç në raste urgjente shëndetësore, sepse ekspertët e shëndetësisë këto komuna i kanë vlerësuar si vatrë më të prekura nga Covid-19", është shprehur ai, duke kërkuar bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë në mes të qendrës së situatave dhe shtabeve komunale të menaxhimit të pandemisë Covid-19, të cilat duhet të riaktivizohen me kapacitet të plotë.



## Japonia ndihmon Kosovën me 700 mijë dollarë në sektorin e shëndetësisë

**PRISHTINË, 6 KORRIK (ER)** - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka pritur të hënën në takim të ngarkuarin me punë të Ambasadës së Japonisë, Mitsunori Ogasawar, të cilin e ka falënderuar për mbështetjen vazhdueshme të shtetit japonez

për Kosovën dhe ndihmën konkrete që ka ofruar gjatë kësaj kohe të pandemisë Covid-19. Tema kryesore e këtij takimi ishte asistencë teknike që Japonia do t'i ofrojë Kosovës për t'u përballur me luftën kundër Covid-19. Më tutje, ambasadori

Ogasawar ka njoftuar se Japonia do t'i japë një shumë të konsiderueshme financiare sektorit të shëndetësisë në Kosovë në vlerë prej 700 000 dollarëve. Ai ka premtuar se edhe në të ardhmen do të vazhdojë ky bashkëpunim i afërt mes dy vendeve mike.



# Oda Ekonomike Amerikane fton bizneset t'i zbatojnë masat për parandalimin e pandemisë Covid-19

PRISHTINË, 6 KORRIK (ER) - Masat administrative të vendosura nga Qeveria e Kosovës, me qëllim të parandalimit të përhapjes së virusit Covid-19, kanë ndikuar rëndë në sektorin privat dhe në ekonominë e vendit në përgjithësi. Kështu thuhet në reagimin e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEA), duke i ftuar bizneset t'i zbatojnë masat për

parandalimin e pandemisë Covid-19. "Me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik dhe parandalimit të përhapjes së mëtejme të pandemisë Covid-19, Oda Ekonomike Amerikane u bënë thirrje bizneseve dhe qytetarëve që t'i zbatojnë rekomandimet e institucioneve shëndetësore, me qëllim të përkrahjes së situatës epidemiologjike do të rëndojë

edhe mbi ekonominë e vendit dhe do ta vonojë rimëkëmbjen ekonomike", thuhet në reagimin e Odës Amerikane të Kosovës. Oda Amerikane u bënë thirrje institucioneve të vendit që masat t'i marrin në pajtim të plotë me përfaqësuesit e komunitetit të biznesit ashtu që të shmangen paqartësitë e mundshme me qëllim të zbatimit të plotë të masave.



## OAK-u kërkon lirimin e plotë të lëndës së parë dhe përkrahje për bizneset

PRISHTINË, 6 KORRIK (ER) - Lirimi i plotë i lëndës së parë, krijimi i arkës patriot, subvencionimi i eksportit, përshkallëzimi i TVSh-së në turizëm dhe hotelieri, ulja e normave të interesit nga BQK-ja, përkrahja e bizneseve nëpërmjet pakos së rimëkëmbjes ishin disa nga çështjet që janë ngrehur në takimin e përfaqësuesve të Odës së Afarizmit të Kosovës me ministrin e Financave, Hykmete Bajrami.

Gjatë këtij takimi përfaqësuesit e OAK-ut kanë theksuar

emergjencën e finalizimit sa më parë të pakos së rimëkëmbjes në mënyrë që bizneset të kenë mundësi që të mbijetojnë dhe operojnë më tutje në këtë kohë pandemie, qasja më e lehtë në financa, rëndësia e subvencionimit të kamatave, riprogramimi i kredive pa kosto shtesë, shtyrja e tatimeve dhe subvencionimi i pagave të të punësuarve u cilësuan disa nga kërkesat më emergjente të bizneseve aktualisht.

Përfaqësuesit e OAK-ut kanë shpalosur propozimet e

bizneseve për pakon e rimëkëmbjes dhe kanë theksuar vështirësitë me të cilat janë duke u përballur bizneset si rezultat i vonësive të mëdha që janë duke u bërë në ekzekutimin e pakos emergjente, ku biznesi në këtë periudhë nuk ka gjetur mbështetje të shteti. Sipas tyre, rënia e qarkullimit dhe operimi larg planifikimeve ka vendosur bizneset në një gjendje të vështirë financiare si rezultat i së cilës rrezikojnë të humbin shumë vende të punës.

Nënkryetari i OAK-së, Arsim

Selmonmusaj, si problematikë ngriti pikën 15 të vendimit të qeverisë për ndërprerjen e aktivitetit në sektorin e identifikuar të institucioneve përkatëse të listuar sipas gjurmimit aktiv epidemiologjik, duke kërkuar ndryshimin e kësaj pike, me qëllim që ky vendim është vështirë i realizueshëm dhe do t'i dëmtojë bizneset në nivel shumë të lartë.

Selmonmusaj, gjithashtu, ngriti si çështje koston prej 5 përqindësh të kthimit të parave të metalta në kartëmonedha, e cila, po ashtu,

po rëndon bizneset.

Ndërkaq ministrja Hykmete Bajrami ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit me përfaqësuesit e biznesit për fuqizimin e sektorit privat. Bajrami i njoftoi përfaqësuesit e OAK-së për angazhimin e Ministrisë për t'i trajtuar nevojat dhe kërkesat e bizneseve dhe u shpreh e hapur për çështjet që ka në kompetencë dikasteri që ajo drejton dhe ka kapacitete, prandaj do të implementuar në programin e rimëkëmbjes.



## Telekomi anulon konkursin për kryeshef dhe për zyrtar financiar

PRISHTINË, 6 KORRIK (ER) - Telekomi i Kosovës nëpërmjet një komunikate për media ka njoftuar të gjithë kandidatët të cilët kanë aplikuar për pozitën "kryeshef ekzekutiv dhe zyrtar

kryesor i Financave dhe Thesarit", për anulimin e konkursit të publikuar në shtypin ditor më datë 15.05.2020, i mbyllur me datë 13.06.2020. Anulimi është bërë

pasi që nuk ka pasur numër të mjaftueshëm të kandidatëve që i plotësojnë kushtet e përcaktuara me konkurs. "I falënderojmë të gjithë aplikantët për shprehjen e

interesimit për të qenë pjesë e TK Sh. A. dhe lutemi që të shikoni uebfaqen e kompanisë për konkurset publike në të ardhmen", theksohet në komunikatën e Telekomit.





# Rukiqi: Nëse nuk ka veprime të shpejta rrezikohen të mbyllen mijëra biznese

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka thënë të hënën se nëse nuk do të ketë veprime të shpejta nga qeveria rrezikohen të mbyllen mijëra biznese dhe mijëra vende të punës. “Pakoja e rimëkëmbjes, pavarësisht vlerës, duhet të implementohet shpejt. Nëse te pakoja e rimëkëmbjes na përsëriten vonesat e pjesës emergjente, atëherë të mos çuditemi se do të humbim dhjetëra mijëra vende të punës dhe do të kemi lëvizje të shumë kompanive tona drejt vendeve të rajonit”, ka thënë Rukiqi në një konferencë për media

parandalimin e përhapjes të valëve të reja të Covid-19”, ka thënë Rukiqi.

Ai ka theksuar se qeveria dhe institucionet e tjera, përfshirë Kuvendin, deri tani nuk kanë arritur as minimalisht t’u dalin në ballë sfidave dhe problemeve ekonomike. Rukiqi ka theksuar se nëse nuk ka veprime të shpejta, në dy javët e ardhshme rrezikohet që të mbyllen mijëra biznese dhe mijëra vende të punës. “Rritja e rasteve duhet të parandalohet me vetëdijesim e jo me mbyllje të bizneseve dhe kufizim të lëvizjes. Nëse është i nevojshëm, vetëdijesimi duhet të arrihet edhe me rritje të ndëshkimeve dhe sanksioneve për të gjithë qytetarët dhe bizneset që nuk respektojnë masat parandaluese. Për të gjithë ata që nuk respektojnë masat parandaluese të ketë ndëshkime. Pasi përfaqësoj bizneset fuqishëm, bëj thirrje që të mbyllen ato biznese që nuk zbatojnë masat parandaluese, e jo komplet sektorët”, është shprehur Rukiqi.

Ai ka shtuar se pakoja emergjente duhet të zbatohet në tërësi pa asnjë vonesë. “Për biznesin dhe punëtorët e sektorit privat, që janë taksapaguesit kryesorë në këtë vend, është shumë pak e rëndësishme kush duhet të marrë vendim. A duhet rishikim buxheti apo jo dhe komplikime të tjera ligjore dhe politike? Sektori privat dhe punëtorët e sektorit privat e presin përkrahjen e ‘dorës së shtetit’ për ta kaluar këtë sfidë. Deri sot shteti ka dështuar të ofrojë këtë përkrahje”, ka deklaruar ai.

Pasi sektori i gastronomisë dhe sektori i transportit janë të prekur edhe nga vendimet e fundit, Rukiqi ka thënë se urgjentisht duhet një konsultë me aktorët e këtyre sektorëve për të marrë vendime për shtim të përkrahjes specifike për sektorët: Riprogramimin e kësteve të kredisë; Lehtësinë për qasje në financa; Përkrahje për pagat dhe qiratë, së paku edhe për tre muaj; dhe shtyrje të deklarimeve dhe pagesave të

tatimeve, së paku edhe për tre muaj.

Ai ka thënë se ky vit do të jetë i vështirë për ekonominë. “Nuk është vit i rritjes apo zgjerimit për asnjë biznes, përveç rritjeve në e-commerce dhe investimet në digjitalizim. Është vit i mbijetesës. Për herë të parë që nga paslufta duhet të mësohemi dhe të bëjmë ndryshime në bizneset tona, në mënyrë që të mbijetojmë pa të hyrat nga vizitat e motrave dhe vëllezërve tanë nga diaspora”, është shprehur Rukiqi, duke theksuar se mbijetesat nuk është e mundshme pa ndërhyrjen e shtetit. “Pakoja e rimëkëmbjes, pavarësisht vlerës, duhet të implementohet shpejt. Nëse te pakoja e rimëkëmbjes na përsëriten vonesat e pjesës emergjente, atëherë të mos çuditemi se do të humbim dhjetëra mijëra vende të punës dhe do të kemi lëvizje të shumë kompanive tona drejt vendeve të rajonit”, ka thënë kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi.

EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 6 KORRIK - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, në një konferencë të jashtëzakonshme për media ka thënë se virusi Covid-19 është këtu për të qëndruar gjatë dhe ne duhet të mësohemi të jetojmë me të. Ai ka thënë se sektori privat dhe punëtorët e këtij sektori presin

përkrahjen e “dorës së shtetit” për ta kaluar këtë sfidë. “Deri sot shteti ka dështuar të ofrojë këtë përkrahje. Qëllimi ynë i përbashkët në ditët dhe në muajt në vijim është të kemi një angazhim të gjithanshëm, përfshirë institucionet, bizneset, mediat, për t’i bindur qytetarët, bizneset, të gjithë shoqërinë, t’i ndryshojnë sjelljet konform normalitetit të ri, gjithmonë duke synuar



## Ministria e Financave merr vendim për moskompensim të 10 përqindëshit nga Trusti

PRISHTINË, 6 KORRIK - Zëvendësministri i Financave, Agim Krasniqi, ka bërë me dije se Ministria e Financave ka marrë vendim për moskompensimin e tërheqjes së 10 përqind nga Trusti Pensional. Sipas Krasniqit, MF-ja

ka paraparë se ky vendim është më i drejtë për shkak të mjeteve në diferencë të qytetarëve. “Ministria e Financave ka marrë vendim që mos të kompensohen mjetet e tërhequra nga Trusti pasi që e kemi parë se ka një diferencë të

madhe në pasqyrën e qytetarëve. Kemi qytetarë që ka vetëm 100 euro dhe të tjerë me 5 000 ose 10 mijë euro. Kjo do të ishte e padrejtë që të kompensohen këto mjete”, ka thënë Krasniqi për “Ekonomia Online”.



## Vdes një person në Malishevë nga ethet hemorragjike

**MALISHEVË, 6 KORRIK (ER)** - Në natën në mes të së shtunës dhe të dielës, një person nga Komuna e Malishevës ka ndër-ruar jetë si pasojë e infektimit me virusin e etheve hemorragjike krome kongo (EHKK). Për gjashtë vjet me radhë në Komunën e Malishevës nuk ka pasur raste të vdekjeve me EHKK, ndërsa për pesë vjet

radhazi nuk ka pasur as raste të infeksionit. "Vdekja I. B. (1976) është konfirmuar nga SHSKUK, përkatësisht drejtori Basri Sejdiu, në komunikim zyrtar me Komunën e Malishevës. Bazuar në të dhënat e deritanishme, tashmë i ndjeri, edhe pse i prekur me EHKK, nuk është trajtuar në Klinikën Infektive, por në një

linikë tjetër dhe në momentet e fundit të jetës, ka pasur nevojë edhe për terapi me oksigjen", ka njoftuar komuna e Malishevës.

Lidhur me këtë rast të hënën është mbajtur një takim urgjent i shtabit komunal për EHKK si dhe çështja është trajtuar edhe në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve.



## Emrat e 16 dëshmorëve vendosen në bjeshkën e Belegut

**DEÇAN, 6 KORRIK (ER)** - Komuna e Deçanit ka bërë me dije se emrat e gjashtëmbëdhjetë dëshmorëve të Batalionit gardist "Shkëlzen Haradinaj" janë vendosur në vendin e rënies së tyre, në bjeshkën e Belegut, konkretisht në trekëndëshin kufitar Kosovë - Shqipëri - Mal i Zi. "Vendi ku kanë rënë për të mos vdekur kurrë gjashtëmbëdhjetë dëshmorë të Batalionit gardist 'Shkëlzen Haradinaj' në përballje të pabarabartë me forcat serbe: Arton Mehmetaj, Përparim Ferizi, Sali Ferizi, Nuredin Gërvalla, Valiant Ferizi, Përparim Shala, Nimon Musaj, Islam Krasniqi, Fehmi Demiqi, Hajrush Demaj, Metë Krasniqi, Nazmi Gradina, Liman Morina, Hysen Mehmeti dhe Xhavit Islami dhe mbetën të plagosur rëndë 15 ushtarë të UÇK-së të cilët bashkë ishin nisur nga spi-



tali ushtarak në Maznik për të bërë bartjen e bashkëluftetarëve për shërim në Shqipëri është emërtuar 'Sheshi-Batalioni gardist 'Shkëlzen Haradinaj'', ka njoftuar komuna e Deçanit.

Ky emërtim është bërë pas kërkesës së Gradës së Dukagjinit "Shkëlzen Haradinaj" dhe kolonelit Abdyl Mushkolaj, drejtuar Asamblesë Komunale të Deçanit më 30 qershor 2020. Kjo kërkesë është votuar unanimisht nga të gjithë asamblistët e subjekteve politike, ndërsa vendimi ka hyrë në fuqi pas miratimit.

Në Bjeshkën e Belegut, në trekëndëshin e kufirit Kosovë - Shqipëri - Mal i Zi, ky shesh dhe këta emra të vendosur të dëshmorëve që kanë rënë në altarin e lirisë më 24 maj 1999, do të jetojnë përjetësisht ndër breza, duke i bërë roje këtij vendi.

## Riorganizohet puna në hapësirat spitalore në Ferizaj



**FERIZAJ, 6 KORRIK (ER)** - Shtabi emergjent, i udhëhequr nga kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka mbajtur një mbledhje pas vendimeve të fundit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për situatën me pandeminë e virusit Covid-19.

Në këtë mbledhje është bërë me dije se institucionet gjegjëse në kuadër të Shtabit emergjent kanë ndërmarrë veprimet e duhura si dhe

angazhime shtesë në përbalimin e kësaj situatë me Covid-19. "Konkluzë e takimit ishte respektimi strikt i vendimeve të qeverisë si dhe angazhimi i institucioneve lokale në këtë drejtim. Temë bosht e këtij takimi ishte riorganizimi i hapësirave spitalore, mes QKMF-së dhe Spitalit Rajonal të Ferizajt, për ta përballuar fluksin eventual të të dyshuarve apo infektuarve me Covid-19. Shtabi mori vendim që të bëjë këtë riorganizim mes

institucioneve me qëllim që më shpejt, më lehtësisht e më me efikasitet të trajtohen rastet e dyshuara me Covid-19 apo edhe të infektuarit", ka njoftuar komuna e Ferizajt.

Sipas këtij njoftimi, kryetari Agim Aliu ka kërkuar shtimin e kontrolleve nga inspektorati i komunës, por edhe institucionet e tjera në dobi të respektimit të masave mbrojtëse dhe kufizuese sa i përket pandemisë Covid-19.

## Gjatë javës në Mitrovicë fillojnë dëgjimet buxhetore për buxhetin 2021-2023

**MITROVICË, 6 KORRIK (ER)** - Drejtuar nga nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, të hënën është mbajtur mbledhja e radhës e bordit të drejtorëve, ku janë diskutuar dhe shqyrtuar çështje të rëndësishme nga fushëveprimi i këtij bordi dhe drejtorive komunale. Fillimisht, drejtori për Financa dhe Zhvillim Ekonomik, Shukri Gashi, ka njoftuar bordin lidhur me orarin e mbajtjes së dëgjimeve buxhetore për projektbux-

hetin e komunës për vitin 2021-2023, me ç'rast ka thënë se janë organizuar gjithsej nëntë dëgjime, në të cilat do të marrin pjesë qytetarë, përfaqësues të OJQ-ve, shoqërisë civile, përfaqësues të institucioneve dhe grupeve të tjera të interesat, të cilët do ta kenë mundësinë t'i japin vërejtjet dhe propozimet e tyre dhe do të bëhet përpjekje të përfshihen në buxhet.

Ndërsa drejtori i Inspeksionit, Hysni Ahmeti, ka njoftuar

ekzekutivin se përgjatë vikendit inspektorët komunalë, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, kanë kryer kontrole të shumta në lokalet e qytetit, me qëllim të respektimit të masave të vendosura nga niveli qendror për mbrojtje nga virusi Covid-19. Gjithashtu, bordi i drejtorëve ka diskutuar edhe për një sërë temash që ndërlidhen me mirëqenien e qytetarëve, ku ka pasur edhe propozime të ndryshme që kanë të bëjnë



me rregullimin më të mirë të funksionimit në secilën drej-

tori dhe rritjen e kualitetit të shërbimeve ndaj qytetarëve.

# SHQIPËRI - KOSOVË, ASGJË E RE NGA FUSHA E SIGURISË

## Pëllumb NAKO

Gjithë këto vite të qeverisjes aktuale janë karakterizuar nga nisma mjaft kaotike, shpesh me natyrë thjesht propagandistike në raport me ndërtimin dhe reformimin e të gjitha institucioneve të sigurisë në vendin tonë. E gjithë kjo mangësi nuk ka sesi të mos reflektohet edhe në marrëdhëniet e bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe të menaxhimit të integruar të saj ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Autoritetet tona qeverisëse janë mburrur deri në kupë të qiellit me bashkëpunimin ndërkombëtar me shumë vende dhe organizma perëndimorë në këtë drejtim, duke i cilësuar ato të shkëlqyera, ndërkohë që me Kosovën nuk është shënuar asnjë hap përpara në raport me gjithçka që është premtuar. Jo vetëm kaq, por deri më sot përveç demagogjisë së përsëritur dhe ripërtëritur me terma të rinj, me Kosovën, me të cilën presupozohet jo thjesht bashkëpunim në fushën e sigurisë, por menaxhim i integruar i saj në të dyja vendet, nuk është parë të hidhet ndonjë hap përpara në ndërtimin e institucioneve të përbashkëta. Aktualisht, nuk ka asnjë lloj

bashkëpunimi bilateral për sigurinë me këtë vend që të jetë i ndryshëm dhe më i afërt në krahasim me vendet e tjera të rajonit, ndërkohë dihet që marrëdhëniet me Kosovën nuk janë të njëjta me të vendeve të tjera. Mbledhjet qeveritare në të dy anët e kufirit, deri më sot nuk kanë prodhuar ndonjë strategji të përbashkët për të integruar organet e sigurisë ndërmjet dy vendeve, apo edhe për t'i ndërtuar ato të përbashkëta, por përkundrazi kanë shënuar madje përplasje. Mjafton të shohësh institucionet e përbashkëta të sigurisë dhe të zbatimit të ligjit ndërmjet ShBA-së dhe Kanadasë që nuk janë në të njëjtin kontekst me Shqipërinë dhe Kosovën, dhe do të shihet se sa shumë punë e koordinuar mund të bëhet ndërmjet dy vendeve para se të ndërmerren nisma të paqarta maksimaliste për t'u realizuar siç është Shengeni Ballkanik ku Serbia vazhdon të ketë në kërkim ndërkombëtar gjithë UÇK-në, gjë që, së paku duket mungesë vizioni. Pra, afrimi i organeve të sigurisë ndërmjet dy vendeve u mundua të zgjidhet në një kontest rajonal tërësisht të pamundur dhe jo bilateral nëpërmjet institucioneve të përbashkëta. Fakt ky për të cilin edhe sot këmbëngulet.

Qeverisja aktuale ka publikuar mjaft nisma, por gjithçka që ekziston deri më sot në fushën e sigurisë ndërmjet dy vendeve, ka ngelur funksionale nga trashëgimia e qeverisjes së mëparshme. Në fushën e sigurisë me Kosovën, kjo qeveri ka bërë shumë fjalë me përmbajtje patriotike, por mjaft pak punë. Rasti më konkret mbetet bashkëpunimi doganor i cili shpesh nënvleftësohet dhe nuk llogaritet si organ mjaft i rëndësishëm i sigurisë. Po t'i referohesh medias vizive dhe asaj të shkruar gjatë mesit të janarit të vitit 2019, ato janë të dominuara nga një lajm: "Dogana e Kosovës fillon punën në Durrës" ose "Kosova me pikë doganore në Durrës". Ngjarja u shoqërua me pompozitet ku në ceremoninë e përfundimit asistoi dhe foli vetë kryeministri ynë, i cili ndër të tjera premtoi: "Tani jemi vetëm në një fazë fillestare... në pranverë do të kemi një procedurë totalisht tjetër dhe do të kemi një kufi totalisht fluid". Pra, bëhej fjalë që zyra doganore e Kosovës në Durrës të kryente veprimet në Portin e Durrësit pa nevojën e Pikës Doganorë të Morinës. Me fjalë të tjera, Kosova do të kishte institucionalisht dalje në det. Kryeministri ynë premtoi si afat pranverën e vitit 2019, por

kaloi edhe pranvera e vitit 2020 dhe tashmë ka mbërritur vera e nxehtë dhe është e njëjta gjendje. Saktësisht një vit e gjysmë më pas, kryeministri doli përsëri përballë publikut dhe nuk bëri një bilanc të integritetit të shërbimeve doganore të të dyja vendeve siç premtoi, por foli për diçka të dakordësuar në parim, ende të papërfunduar. Në konferencën e përbashkët për shtyp me kryeministrin kosovar Hoti, shefi i qeverisë tha: "Sot kemi folur për doganën e Kosovës në Durrës. Në parim është dakordësuar, por në zbatim ende nuk është e plotë, pasi ajo që Hoti ka ngritur në bisedë, përbën thelbin e marrëveshjes, jo një stacion i parë, i pasuar nga një i dytë kontrolli në Morinë, por një i vetëm në Durrës...". Në fakt, një hap i tillë nuk është gjë tjetër veçse "dalje e Kosovës në det" si Sllovenia që i shërben Austrisë në kontekstin e Shengenit. Atëherë përse mbeti dhe vazhdon të mbetet përgjysmë "dalja e Kosovës në det"? Sepse shefi i qeverisë ndërroi strategji dhe mori rolin e liderit rajonal duke vendosur që gjithë bashkëpunimin bilateral ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë ta zgjidhte në një kuadër rajonal siç ishte Minishengeni Ballkanik. Një

nismë e tillë politikisht joshëse mbetet mjaft e koklavitur për t'u vënë institucionalisht në jetë sado mirë të përkthehet Kodi Shengen në shqip. E filluar me shumë nxitim, pa ekspertizën e duhur teknike, pa parapërgatitje për të shoshitur pengesat, pa një vizion institucional, pa një platformë konkrete të shtrirë në kohë dhe në gjithë komponentët përbërës jo të një, por të shumë marrëveshjeve shumëpalëshe, nisma e Shengenit Ballkanik u kthye në përplasje të Shqipërisë me Kosovën. Ndaj dhe Kryeministri aktual i këtij vendi i kujtoi këto ditë shefit tonë punën e lënë përgjysmë në Durrës, pra të braktiste punët e botës e të merrej me ato të shtëpisë. Dogana e Kosovës në Durrës mbetet nisma konkrete e vetme në integrimin e organeve të sigurisë të të dyja vendeve dhe ajo deri tani ka mbetur përgjysmë. Në këto pothuaj tetë vite qeverisje do të ishte e mrekullueshme sikur të ndërtohej qoftë edhe një institucion konkret i sigurisë së përbashkët apo i integruar ndërmjet dy vendeve. Nëse të dyja vendet do të kishin institucione të përbashkëta apo të integruara të sigurisë e më gjerë, problemet e Shengenit Ballkanik do të dilnin në Serbi dhe jo në Kosovë.



## Rezultatet e para konfirmojnë fitoren e HDZ-së në Kroaci

ZAGREB, 6 KORRIK - Bashkimi Demokratik i Kroacisë (HDZ), i qendrës së djathtë, ka siguruar një fitore të madhe në zgjedhjet parlamentare më 5 korrik, kanë treguar rezultatet e para të bëra publike. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (SEC) përpunoi të dhënat nga 68.98 për qind të vendvotimeve. HDZ pritet të ketë 66 nga 151 vende në parlamentin e ri dhe koalicioni i partive të qendrës së majtë, i udhëhequr nga Partia Social Demokratike (SDP), ka 41

vende. Sipas këtyre të dhënave jo të plota, Lëvizja Atdhetare e Miroslav Shkora ka 15 ulëse, koalicioni i partive të majta dhe të gjelbra gjashtë vende, ndërsa Partia Popullore kroate 1 vend. Koalicioni i partive liberale ka siguruar tri mandate. Të paktën 76 vota të ligjvënësve të sapozgjedhur nevojiten për të formuar një shumicë të re qeverisëse. "Një rezultat i tillë për HDZ nuk është vetëm i shkëlqyeshëm, por një detyrim", ka thënë kreu i HDZ-



s, njëherësh kryeministër i vendit, Andrej Plenković, para përkrahësve. Mbajtja e zgjedhjeve u mbizotërua nga debatet mbi koronavirusin. Kroacia ka regjistruar 113 vdekje dhe 3 100 të infektuar. Dy javët e fundit ka pasur një ngritje graduale të rasteve me koronavirus. Masat e izolimit dhe një rënie e të ardhurave nga turizmi veror pritet të shkaktojnë një tkurrje prej 10 për qindësh në ekonomi.

## Izraeli lëshon satelitin e ri spiun për t'i monitoruar armiqtë



JERUSALEM, 6 KORRIK - Ministria e Mbrojtjes e Izraelit ka njoftuar për nisjen e suksesshme të një sateliti të ri spiun, për të cilin ministria tha se do të siguronte një mbikëqyrje me cilësi të lartë për inteligjencën e saj ushtarake. Izraeli në vazhdimësi ka qenë duke ndërtuar aftësitë e tij të

mbikëqyrjes, për të monitoruar armiqtë si Irani, programin bërthamor të të cilit e sheh si një kërcënim të madh. Ministria e Mbrojtjes tha se sateliti Ofek 16 ishte nisur më 6 korrik në orën 4:00 të mëngjesit. Imazhet e para nga sateliti priten pas rreth një jave. "Ne do të vazhdojmë të forcojmë dhe

ruajmë aftësitë e Izraelit në çdo front, në çdo vend", tha ministri i Mbrojtjes, Benny Gantz, në një deklaratë. Kontraktori kryesor për projektin është kompania në pronësi shtetërore Aerospace Industries, ndërsa ngarkesa e satelitit u zhvillua nga firma mbrojtëse, Elbit Systems.

## Arrestohet profesori që kritikoi trajtimin e pandemisë nga Kina

PEKIN, 6 KORRIK - Një profesor që kritikoi autoritetet kineze për trajtimin koronavirusit është arrestuar nga policia. Xu Zhangrun, i cili ka qenë nën arrest shtëpiak, u mor nga shtëpia e tij në Pekin të hënën, thanë miqtë e tij. Profesori i drejtësisë ka kritikuar disa herë liderin aktual të Kinës, Xi Jinping. Policia nuk ka komentuar publikisht mbi arrestimin dhe është e paqartë se me çfarë akuzash përballët Zhangrun, raporton "BBC".

Një mik i tij i tha agjencisë së lajmeve "AFP" se gruaja e profesorit Zhangrun kishte pranuar një telefonatë, përmes së cilës asaj i thuhej se burri i saj akuzohet për kërkesë prostitucioni, derisa ishte në qytetin Chengdu. Miku i tij e hodhi poshtë akuzën si "qesharake". Liria e shprehjes është nën kontroll të rreptë në Kinë. Ata që flasin kundër autoriteteve rrezikojnë arrestimin dhe dënimin me burgim. Geng Xiaonan, një mik i profesorit, i tha "New York Times"

se ai ishte "i përgatitur mendërisht se do të arrestohet". Më parë atij i ishte ndaluar puna në Universitetin Tsinghua - një nga institucionet kryesore arsimore të vendit, pasi ai foli kundër heqjes së kufijve të mandatit presidencial, masë kjo që lejonte presidentin Xi të mbetet në postin e tij për gjithë jetën. Ai ishte vendosur në arrest shtëpiak, në fillim të këtij viti, pasi publikoi një artikull ku kritikonte mënyrën se si presidenti Xi dhe qeveria kishin trajtuar shpërthimin e koronavirusit.



## Në Maqedoninë e Veriut vdesin edhe 5 persona nga Covid-19

Shkup, 6 korrik - Ministria e Shëndetësisë e Maqedonisë së Veriut njoftoi të hënën edhe për 5 të vdekur nga koronavirusi, me të cilët numri i viktimave nga sëmundja që e shkakton ai, Covid-19, arrin në 346. Tri nga viktimat e fundit janë nga Shkupi, ndërsa nga një është regjistruar në Kumanovë dhe Strugë. "Parashikimet e autoriteteve shëndetësore botërore se koronavirusi do të zhduket gjatë muajve të verës nuk janë materializuar. Është një konfirmim se virusi është këtu.



Padyshim se do të qëndrojnë për një kohë të gjatë dhe ne duhet të jemi të përgatitur. Ne duhet ta përgatisim sistemin e kujdesit

shëndetësor dhe t'i respektojmë masat e mbrojtjes personale", tha ministri i Shëndetësisë i Maqedonisë së Veriut, Venko

Filipçe, duke paralajmëruar valë të re në vjeshtë. "Sipas të gjitha analizave dhe parashikimeve, mbetet supozimi se virusi në vjeshtë do të përhapet më shpejt dhe do të jetë më i fuqishëm se në këtë periudhë, sepse njerëzit do të jenë në hapësira më të mbyllura dhe kjo do të çojë në përhapjen më të madhe të virusit", tha Filipçe. Sipas njoftimit të Ministrisë së Shëndetësisë, nga testimi i 894 mostrave në 24 orët e fundit, me koronavirus janë diagnostikuar 78: prej tyre: 26 në Shkup, 17 në

Shtip, 9 në Tetovë, 5 në Gostivar, ndërsa numër më i vogël i të infektuarve në 11 qytete të tjera. Për dallim nga ditët e tjera, numri i të shëruarve nga koronavirusi në Maqedoninë e Veriut të hënën arriti në 172 apo gati 100 më shumë se i të infektuarve që, njëherësh, paraqet edhe shifrën më të lartë të të shëruarve në dy muajt e fundit. Maqedonia e Veriut ka konfirmuar gjithsej 7 124 raste me koronavirus. Prej tyre, 3 199 janë shëruar, ndërsa aktive mbeten 3 579 raste.

## Rihapet Muzeu Louvre në Paris

PARIS, 6 KORRIK - Muzeu me famë botërore Louvre në Paris është rihapur sot (6 qershor) pasi ishte i mbyllur gjatë katër muajve të kaluar për shkak të pandemisë. Numri i vizitorëve do të jetë i

kufizuar, ndërsa mbajtja e maskave mbrojtëse në fytyrë është e detyrueshme. Galeritë, në të cilat distancimi fizik është më vështirë të respektohet, do të mbesin të mbyllura. Muzeu zakonisht

pranon 10 milionë vizitorë në vit, shumica e të cilëve nuk janë nga Franca. Kjo e bën atë muzeun më të vizituar në botë. Humbjet financiare gjatë pandemisë llogaritet të jenë 40 milionë euro.





# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

- Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]
- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
  - ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
  - ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
  - ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
  - ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
  - ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
  - ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
  - ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
  - ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
  - ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**E jashtëzakonshme**

## Zbulim i ri arkeologjik në Himarë, arkeologët zbulojnë varrezën tumulare të shekullit XV-XII

Një zbulim i ri arkeologjik ka ndodhur në Himarë. Arkeologët kanë gjetur një varrezë tumulare të shekullit XV-XII para lindjes së Krishtit. Lajmi është bërë me dije nga gazetari Aleksandër Çipa i cili ka publikuar në llogarinë e vet në "Facebook" disa fotografi nga ky zbulim. Sipas arkeologëve, zbulimi është i një rëndësie të veçantë, pasi është i pari sit arkeologjik i këtij lloji në bregdetin e Himarës.



**FOTO E DITES**



Pamje nga plazhi i Semanit, duke respektuar distancën kundër Covid-19

**BARSOLETA E DITËS**



**Polici:** Për çfarë nevojiten këto fara të mollëve?  
**Tregtari:** Të japin mend.  
**Polici:** Sa kushtojnë?  
**Tregtari:** Dy euro.  
**Polici:** Ja të hollat, dhe po i ha tani.  
**Tregtari:** Të bëfshin mirë!  
**Polici:** Më fal, por me mashtrove, sepse me dy euro do t'i kisha blerë tri kilogramë molla.  
**Tregtari:** A e sheh se me vetëm tri fara që hëngre u mbushë mend?



**Në Kino ABC nuk ka shfaqje**

## Vdes nga koronavirusi aktori 41-vjeçar i Hollywood-it



Aktori i Hollywood Nick Cordeiro ka vdekur nga koronavirusi. Cordeiro ndërroi jetë në moshën 41-vjeçare dhe prej 90 ditësh ishte i shtruar në spital në Los Angeles për shkak të komplikacioneve nga Covid-19.

**Gruaja e aktorit Nick, Amanda Clutes ka dhënë lajmin e trishtë përmes një postimi në Instagram.**

"Tani Zoti ka një engjell tjetër në parajsë. Burri im i dashur

ndërroi jetë këtë mëngjes. Ai e donte shumë familjen e tij, dhe tani ai e ka lënë këtë botë të buzëqeshur. Kam dhimbje, zemra ime është e thyer sepse nuk mund ta imagjinoj jetën tonë pa atë. Nick kishte një dritë. Ai ishte shoku i të gjithëve. Ai e donte shumë të dëgjonte, të ndihmonte dhe të fliste. Ai ishte një aktor dhe muzikant i jashtëzakonshëm. Ai ishte një baba dhe burrë i shkëlqyeshëm", ka shkruar ajo.

**E rrallë**

## Zbulohet vrma e zezë gjigante

Përmyllën analizimet mbi një vrime të zezë gjigante. E zbuluar në vitin 2018, është 8 000 herë më e madhe se vrma e zezë që ndodhet në qendër të galaktikës sonë. Masa e saj është 34 miliardë herë më e madhe se e diellit. Ky gjigant kozmik falë fushës gravitacionale është në gjendje të thithë dhe përpijë çdo gjë që

gjen përpara, përfshirë këtu edhe dritën. Ndodhet miliarda vite dritë larg sistemit diellor. Identikiti i kësaj vrime të zezë gjigante është përshkruar në revistën mujore shkencore të Akademisë Mbretërore Astronomike të Britanisë së Madhe. Sipas autorëve të kërkimit, është një ndër vrimat e

zeza më të mëdha dhe të fuqishme të universit dhe ende nuk dihet sesi është krijuar, por mendohet se është formuar 700 milionë vjet pas Big-Bang. Ata shpjegojnë se në bazë të kalkulimeve të deritanishme, kjo vrime e zezë arrin të përpijë në ditë një masë ekuivalente me Diellin tonë.



 <p><b>DASHI</b> Është tepër e rëndësishme që të qëndroni brenda kufijve këtë javë. Me Merkurin që largohet nga shenja juaj, nuk do të jeni popullor sa më parë. Jini entuziast, por edhe realist.</p>	 <p><b>DEMI</b> Pak fjalë të mira nga janë gjithçka duhet për të gëzuar një shok, apo koleg që po kalon një periudhë të vështirë. Jeta supozohet të jetohet në mënyrë të lumtur e buzëqeshja ndihmon.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Nuk mjafton vetëm të shqetësoheni. Ngrihuni dhe veproni. Dikush që do të takoni në udhëtime mund t'ju japë këshilla të vlefshme.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Nëse merrni një ofertë financiare të çfarëdollojshme ditë në vijim, duhet të mendoheni mirë nëse ia vlen. Mund të duket tërheqëse, por mund të përfshijë angazhim afatgjatë që mund të mos jetë në interesin tuaj më të mirë.</p>	 <p><b>LUANI</b> Merkuri, planeti i komunikimeve, largohet nga ndikimi mbi shenjën tuaj këtë javë, kështu që mos u surprizoni nëse të tjerët nuk kuptojnë çfarë po përpiqeni të thoni.</p>	 <p><b>VIRGJËRESHJA</b> Të tjerëve mund t'ju duket se ju jeni mbërthyer në mungesën e vetëbesimit, por e vërteta është se ju jeni vetëm i tensionuar.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Mund të jetë diçka e zgjuar të mos imponoheni shumë me opinionet tuaja, pasi ajo që mund të mendoni se është e drejtë sot, mund të mos jetë e njëjtë në të ardhmen.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Nëse një koleg përpiket tua hedhë ju fajn duhet ta refuzoni menjëherë. Nëse hezitoni, qoftë edhe për një sekondë, mund të mbillni farat e dyshimit tek ata që ju besojnë.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Shanset janë që ju të vini në pikëpyetje diçka që gjithmonë e keni besuar. Mendoni mbi këtë çështje, por mos nxitoni të ndryshoni opinion.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Mund t'ju besoni njerëzve me të cilët do të merreni këtë javë, por duhet të kontrolloni detajet para se të bini dakord për çfarëdolloj marrëveshjeje.</p>	 <p><b>UJORI</b> Nëse mendoni se ka diçka të cilën duhet tuaj thoni të dashurve tuaj këto kohë, atëherë flitni, para se të jetë shumë vonë.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Nuk ju duhet ta pëlqeni një person në mënyrë që të punoni në mënyrë efektive me ta. Nëse jeni i zgjuar do t'i fshihni ndjenjat tuaja këtë fundjavë dhe të fokusoheni në detyra.</p>

## Nicole Scherzinger shijon pushimet romantike me të dashurin në Portugali



**K**ëngëtarja Nicole Scherzinger dhe i dashuri i saj Thom Evans janë duke kaluar pushime romantike në Portugali. 42-vjeçara është fotografuar duke


u hedhur në krahët e partnerit të saj 35 vjeç. Dyshja shihet se po kalojnë mjaft mirë atje dhe kjo vihet re nga fotografitë e publikuara në rrjete sociale.

## Olta Gixhari tregon se kur do të bëhet nënë



**A**ktorja e njohur shqiptare Olta Gixhari është duke prit-ur që së shpejti të bëhet nënë për herë të parë. Gixhari dhe partneri i saj janë duke qëndruar në Spanjë, atje ku edhe po i shijojnë ditët e nxehta të verës, por ajo

vazhdon ta mbajë të fshehur portretin e babait të fëmijës. Së fundmi aktorja ka publikuar një foto shumë të ëmbël, ku ka zbuluar se ndodhet në muajin e 8 të shtatzënisë dhe tashmë pritjes së lindjes po i vjen fundi.



## Luana Vjollca "ngre temperaturat" pasi lë vetëm bikinitë

**L**uana Vjollca është një nga femrat më të bukura dhe seksi të shoubizit shqiptar. Autorja dhe moderatorja e njohur ka publikuara fotografi në

llogarinë e vet në "Instagram". Bukuroshja bionde "ka ngritur temperaturat" me foton në bikini nga kjo verë, ku shfaqet në formë të mirë.

## Kanye West sfidon Trumpin dhe Bidenin në garën presidenciale



**N**uk kanë qenë të paktë yjet e shoubizit të cilët kanë shprehur dëshirën e tyre për të kandiduar për president të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Edhe reperi Kanye West, i cili është një mbështetës shumë i madh i presidentit amerikan Donald Trump, ka bërë me dije se do të kandidojë për shef të ShBA-së. Kjo shihet si një sfidë kundrejt Trumpit

dhe rivalit të tij demokrat, ish-zëvendëspresidentit Joe Biden. Nëpërmjet një postimi në llogarinë e vet në "Twitter", West është shprehur se tani më shumë se kurrë ka ardhur koha që të përmbushet premtimi i amerikanëve për të ndërtuar një të ardhme më të mirë. Sipas tij, kandidatura për president të Amerikës është gjëja më e veçantë në jetë.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

'BUJQËSIA'

TEL: 045/82 82 82

# Rexha: Dua titullin dhe 'Këpucën e Artë'

Titulli i kampionit në Superligë dhe "Këpuca e Artë" janë synimet e Kastriot Rexhës edhe në këtë edicion të garave. "Jemi duke kaluar nëpër një formë të mirë. Ndashja e radhës kundër Feronikelit dhe është shumë e rëndësishme dhe vendimtare për vazhdimësinë e kampionatit, po ashtu edhe ruajtja e distancës ndaj rivalëve për titull. Besoj se do të vazhdojmë me lojërë të mira dhe rezultate pozitive edhe në këto ndeshje dhe në fund të shpallemi kampionë", ka thënë Rexha

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 6 KORRIK - Sulmuesi i Dritës, Kastriot Rexha, ka shprehur optimizëm se skuadra e tij mund të shpallet kampione në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Shtatlarti nga kryeqyteti ka thënë të hënën për "Epokën e re" se ndeshja e radhës që Drita e zhvillon ndaj Feronikelit është e rëndësishme dhe, ndoshta, edhe vendimtare në garën për titull. "Jemi duke kaluar nëpër një formë të mirë dhe ndeshja e radhës kundër Feronikelit është shumë e rëndësishme dhe vendimtare për vazhdimësinë e kampionatit, po ashtu edhe ruajtja e distancës ndaj rivalëve për titull. Besoj se do të vazhdojmë me lojërë të mira

dhe rezultate pozitive edhe në këto ndeshje dhe në fund të shpallemi kampionë", ka thënë Rexha.

Drita është në pozitën e parë në elitë dhe ka katër pikë më shumë se përcjellësja e parë, Prishtina. Sulmuesi me përvojë të madhe në futbollin e Kosovës realizoi një nga katër golat e fitores ndaj Llapit, kurse tash është në kuotën e 13 golave. Dy më shumë se Rexha i ka shënuar Blend Baftiu i Ballkanit, kurse një më shumë e ka Arb Manaj i Trepçës '89. Rexha ka konfirmuar se synon ta rrëmbejë edhe në këtë edicion "Këpucën e Artë". "Detyra e secilit sulmues është të shënojë sa më shumë gola, pasi e ndihmon skuadrën për të arritur tek objektivi. Edhe unë si gjithmonë angazhohem dhe do të përpiqem të shënoj sa më shumë gola, pse jo edhe

siç jet ta rrëmbejë 'Këpucën e Artë'", ka shtuar ai.

Sulmuesi i shumë skuadrave në Kosovë në pjesën e parë të kampionatit ka luajtur për skuadrën e Feronikelit, por në janar është larguar nga ky klub për shkak se nuk bënte pjesë në projektin e klubit nga Drenasi. Megjithatë, sulmuesi në fjalë ka vendosur që ta padisë ish-klubin në Federatën e Futbollit të Kosovës me arsyen se ende nuk i ka kryer të gjithë obligimet financiare. Pavarësisht insistimit të gazetës, Rexha nuk dëshoi të bëjë publike shumën e saktë që i detyrohet Feronikeli. "Besoj se brenda dy ditësh do ta dërgoj lëndën në FFK. Kjo nuk ishte dëshira ime, por jam mundur që të kontaktoj me presidentin e klubit, por një gjë e tillë ka qenë e pamundur", ka deklaruar Rexha.

SHKURT

## Sokoli: Januzi është më i miri në Superligë, duhet të ftohet në Përfaqësuese

Trajneri Bylbyl Sokoli, në emisionin "Dueli sportiv", ka thënë se Ahmed Januzi është sulmuesi më i mirë në Superligë dhe se duhet të ftohet nga Përfaqësuesja e Kosovës. "Mendoj se Januzi është sulmuesi tipik më i mirë aktualisht në Superligë. Ka shumë meritë që Prishtina është aty ku është. Januzi është një djalosh shumë punëtor dhe ka karrierë të bujshme. Unë mendoj se duhet t'i ofrohet edhe mundësia që t'i bashkohet Përfaqësueses së Kosovës sepse ka cilësi dhe përvojë ndërkombëtare", ka deklaruar Sokoli.

## Spartak Moska interesohet për Vojvodën

Pas klubeve italiane si Lazio, Torino e Atalanta, interesim për futbollistin e Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Mërgim Vojvoda, ka shfaqur edhe klubi i njohur rus Spartak Moska. Vojvoda 25-vjeçar është nën kontratë me klubin e elitës belge Standard Liege. Mirëpo, ai po pritet të largohet këtë verë. Vojvoda ka kontratë me Standardin deri në verën e vitit 2023.

## Mustafi afër marrëveshjes së re me Arsenalin

Shkodran Mustafi dhe Arsenalin duket të jenë afër një marrëveshjeje të re, sipas raportimeve nga "Daily Star". Mbrojtësi i përfaqësueses gjermane është kritikuar këta katër vjet sa ka luajtur tek Arsenalin, mirëpo trajneri Mikel Arteta duket të jetë i impresionuar me të. Kështu, duket të jetë iniciativa e teknikut spanjoll që futbollistit me prejardhje shqiptare t'i zgjatet qëndrimi në "Emirates Stadium".



## Messi do të pensionohet te Barcelona

**BARCELONË, 6 KORRIK** - Në ditët e fundit qarkulluan të tjera lajme se Lionel Messi nuk dëshiron ta rinovojë kontratën me Barcelonën që skadon në vitin

2021, për t'u larguar me parametër zero pas një viti. Gjithsesi duket se nuk ndan të njëjtin mendim presidenti i Barcelonës, Josep Maria Bartomeu, i cili në

një intervistë i ka siguruar fansat se Barça nuk do të privohet nga shërbimet e yllit argjentinas. "Leo e ka thënë pafundësisht se do që ta mbyllë karrierën te Barcelona.

Nuk mund të shpjegoj tani çka diskutojmë çdo javë. Tani duhet të jemi të përqendruar në La Liga dhe në Ligën e Kampionëve", është shprehur Bartomeu.



## Hajrizi: Në Ligën Kosovë - Shqipëri, fokusi të jetë te lojtarët e rinj



**PRISHTINË, 6 KORRIK** - Komuniteti i basketbollit e ka vlerësuar shumë pozitive iniciativën nga Federata e Basketbollit e Kosovës dhe Shqipërisë për formimin e Ligës Kosovë - Shqipëri. Në këtë Ligë pritet të marrin pjesë katër skuadrat më të mira nga Kosova dhe Shqipëria, kurse është planifikuar të fillojë në muajin shtator. Kapiteni i Pejës, Drilon Hajrizi, ka thënë se kjo ide është shumë e mirë, megjithatë duhet të shfrytëzohet për t'u dhënë hapësirë lojtarëve të rinj. "Ideja

për formimin e Ligës së përbashkët Kosovë - Shqipëri është shumë e mirë. Megjithatë, kjo Ligë duhet të shfrytëzohet për t'u dhënë hapësirë lojtarëve të rinj dhe të mos jetë një ligë ku skuadrat do të synonin me çdo kusht titullin e kampionit. Basketbollistët e rinj kanë nevojë për sa më shumë ndeshje ndërkombëtare në mënyrë që të fitojnë përvojë. Kjo mund t'u ndihmojë atyre në të ardhmen. Sa më shumë ndeshje ndërkombëtare aq më shumë

përvojë do të fitojnë. Nëse u japim hapësirë lojtarëve të rinj, atëherë kjo Ligë është shumë e mirëseardhur. Por, nëse garohet vetëm për titullin e kampionit, atëherë mund të kemi shumë shpenzime dhe pak përfitime", është shprehur Hajrizi për faqen zyrtare të FBK-së. Federata e Basketbollit e Kosovës dhe Shqipërisë janë duke punuar intensivisht për jetësimin e ëndrrës së shumë shqiptarëve për një ligë të përbashkët mes dy vendeve.

## Bottas: Shumë presion për një fitore

**ZELTWEG, 6 KORRIK** - Sezoni 2020 në Formula 1 nisi me një fitore për pilotin finlandez Valtteri Bottas, që ishte superior ndaj shokut të tij të skuadrës te Mercedesi, Lewis Hamilton, gjatë gjithë fundjavës. Bottas siguroi të shtunën "pole position" dhe më pas të dielën dominoi në garë dhe e fitoi atë. "Ishte një garë ku presioni ndaj meje ishte shumë i madh. Gjatë garës makina e sigurisë hyri disa herë në pistë dhe kjo nuk është e lehtë për një pilot që kryeson, pasi i duhet të mbrohet nga sulmet e rivalëve dhe Hamiltoni e pati një ndihmë", ka thënë Bottas. "Hamilton pati disa mundësi për të më parakaluar, por nuk ia doli dot. Gjithsesi, nuk ka mënyrë më të mirë për ta nisur sezonin sesa me një fitore. Kjo fitore më motivon edhe për garën e dytë këtu në



Austri", ka deklaruar Bottas. Dy garat e para sezonale të

Formulës 1 do të zhvillohen në pistën austriake të Zeltwegut.

### SHKURT

#### Tare, futbollistëve: Ende nuk ka mbaruar asgjë

Humbja ndaj Milanit 0-3 brenda në "Olimpico" ka demoralizuar jo pak Lazio që tashmë e sheh veten -7 pikë nga Juventus kryesues. Mungesa e Immobiles dhe e Caicedos ndikuan në duelin ndaj kuqezinjve. Drejtori sportiv Igli Tare ka reaguar duke thënë se ka ende besim te futbollistët dhe se asgjë nuk ka përfunduar. "Ju jeni të fortë, keni qenë të mrekullueshëm. Tani nuk është momenti të bëhemi pesimistë, por duhet të mendojmë për Leccen. Jeni të lodhur, pushoni dhe le të vazhdojmë sërish. Ju dhatë gjithçka! Nuk ka mbaruar asgjë akoma", ka thënë Tare për "Corriere dello Sport".

#### Allegri: E kam refuzuar Realin

Ish-trajneri i Milanit dhe Juventusit, Massimiliano Allegri, ka zbuluar se ka refuzuar një ofertë të Real Madridit. "Dy vjet më parë kisha kontakte, por asgjë nuk erdhi pasi unë kisha kontratë me Juventusin. Tutje, unë kisha përkushtim moral ndaj klubit dhe tifozëve", ka thënë Allegri, i cili është dëshirë e kamotshme e PSG-së.

#### Mandzuziqi drejt rikthimit në Serinë A

Sulmuesi Mario Mandzuziqi e ka shkëputur kontratën me Al-Duhail. Mediat në Itali raportojnë se sulmuesi kroat mund të rikthehet në Serinë A, derisa interesim për të kanë shfaqur Hellas Verona dhe Benevento. Mandzuziqi ka luajtur për Juventusin, Atletico Madridin, Bayern Munchenin dhe Wolfsburgun.

#### Plaçkitet shtëpia e Riberys

Shtëpia e yllit francez të Fiorentinës, Franck Ribery, në Firenze, është plaçkitur të dielën mbrëma, shkruan "La Repubblica". Ribery luajti në ndeshjen kundër Parmës të dielën dhe mori një lëndim të kyçit. Kur u kthye në shtëpi ai zbuloi se ishte plaçkitur. Ende po bëhet vlerësimi i gjërave që mungojnë, por raportohet se janë vjedhur gjëra të vlefshme.

#### Pique: Nuk na pëlqen të jemi pas Realit, luftojmë deri në fund

Mbrojtësi i Barcelonës, Gerard Pique, i gëzohet fitores dhe lojës së mirë kundër Villarealit. Mbrojtësi spanjoll kërkon që skuadra të paraqitet njëjtë edhe në ndeshjen kundër Espanyolit. "Këto tri pikë ishin të rëndësishme për ta vazhduar luftën. Loja, gjithashtu, ishte shenjë e identitetit tonë. Tani duhet të vazhdojmë në këtë linjë deri në fund të sezonit, duke filluar me ndeshjen tjetër kundër Espanyolit", ka thënë Pique. "Ekzistojnë disa faktorë, njëri lidhet me situatën e repartit ofensiv, që i ka lejuar sulmuesit të jenë më afër portës së rivalit. Po ashtu, Antoine ka qenë në gjendje të hyjë në lojë më shumë".

Në lidhje me situatën e La Ligës, Pique ka pranuar se nuk i pëlqen që Barça të jetë pas Realit. "Nuk na pëlqen të jemi prapa Realit, por do të luftojmë deri në fund". Sa i përket gjestit që bëri në fushë, kur goli i Messit u anulua nga VAR, ai e kufizoi veten, duke thënë: "Nuk e mbaj mend gjestin, në fushë je plot adrenalinë".

## SHPALLJE PËR SHITJE

Ndërmarrja e Re "MIM Golesh" Magure

Ndërmarrja e Re (N.R.) "MIM Golesh", Magure e cila është në Administrim të Drejtpërdrejt të AKP-së, SHPALLË këtë:

FTESË PËR OFERTË  
PËR SHITJEN E MATERIALVE

EMRI ZYRTAR: Ndërmarrja e Re "MIM Golesh"

ADRESA POSTARE: Magure

## I. LËNDA E KONTRATËS;

Autoriteti kontraktues ka për qëllim shitjen e materialeve si vijon:

1. Dunit I thërrmuar, fraksion 0 – 4mm , rreth 13800 m<sup>3</sup>,
2. Dunit I thërrmuar, fraksion 4 – 8 mm , rreth 2500 m<sup>3</sup>,
3. Dunit I thërrmuar, fraksion 8 – 11 mm rreth 1100 m<sup>3</sup> dhe
4. Shkëmbinj ultrabazik (material për mbushje), fraksion – 60 mm , rreth 36700 m<sup>3</sup>

## II. KUSHTET E OFERTIMIT:

1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit, numrit fiskal, certifikata e TVSH-se, numrin e telefonit kontaktues dhe adresa. Oferta duhet të përmbajë çmimin me TVSH, duhet të jete shume e qartë dhe të përfshijë të gjitha detajet e kërkuara, e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik;

## III. VIZITA E MATERIALEVE

Palët e interesuara, materialet e larte cekura mundë t'i shikojnë prej datës 07.07.2020 deri me 12.07.2020 prej orës 10:00h deri në orën 14:00h përmes personit kontaktues z. Shefik Imeri, nr. tel mob. 049/455-869 ose fix. 038/588-700.

## IV. KRITERET PER DHENJEN E KONTRATES :

1. Çmimi më i lartë i ofruar për m<sup>3</sup> të materialit

## V. AFATI KOHOR DHE VENDI PER DOREZIMIN E OFERTAVE

Ofertat finale të cilat duhet të jenë në zarf të mbyllur, duhet të dërgohen me datën **13.07.2020** nga ora **13<sup>00</sup>** deri në orën **14<sup>00</sup>** në adresën e mëposhtme: Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. Agim Ramadani nr.08.

Ofertat do të hapen me datë **13.07.2020** në ora **14<sup>10</sup>** në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, rr. Agim Ramadani nr.08;.

## VI. Përfaqësuesit legjitim të ofertuesve, mund të marrin pjesë me rastin e hapjes së ofertave.



## NJOFTIM

Telekomi i Kosovës Sh.A njofton të gjithë kandidatët të cilët kanë aplikuar për pozitat: Kryeshef Ekzekutiv dhe Zyrtaar Kryesor i Financave dhe Thesarit, për anulimin e konkursit të publikuar në shtypin ditor me datë.15.05.2020 i mbyllur me datë 13.06.2020, sepse nuk ka numer te mjaftueshëm të kandidatëve që i plotësojnë kushtet e përcaktuara me Konkurs.

I falënderojmë të gjithë aplikantët për shprehjen e interesimit për të qenë pjesë e TK Sh.A, dhe luteni që të shikoni web faqen e kompanisë për konkurset publike në të ardhmen.

## OBAVEŠTENJE

Telekom Kosova d.d. obaveštava sve kandidate koji su se prijavili na položaje: Izvršni Direktor i Glavni Finansijski Direktor, da je konkurs objavljen u dnevnoj štampi dana 15.05.2020., poništen zbog nedovoljnog broja kandidata koji ispunjavaju uslove određene konkursom.

Zahvaljujemo svim kandidatima koji su izrazili interesovanje da budu deo TK d.d., i upućujemo vas da pratite web stranicu kompanije za buduće javne konkurse.

## NJOFTIM

Njoftojmë të interesuarit se me datën 15.07.2020 (e mërkurë) me fillim në ora 12:00 z. Pajtim Imeri mbron Punimin e Masterit me titull: "Aftësia inbibuese dhe ndikimi i stresit të kripërave të CaCl<sub>2</sub> te fara e grurit".

Mbrojtja publike do të jetë në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë.

## RESTAURANT

**SWISS**  
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

► D.P.T. Kiosku "Fati" shpall të pavlefshëm certifikatën e biznesit me numër: 70507935.

► "Rene Dental" nga Prishtina, shpall të pavlefshme certifikatën e regjistrimit të biznesit më numër: 810851081.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



**ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS**  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Në bazë të nenit 57 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shendetësor, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 4 dhe 5 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

**KONKURS**

**ASISTENT/E ADMINISTRATIV/E PËR KOMISIONE TË PËRHERSHME**

Numri i pozitave: 1 (një vend pune),

Nr. ref: 02/2020

Kohëzgjatja e Kontratës: 6 muaj me mundësi vazhdimi (Orar i Plotë, Zëvendësim i Pushimit të J.chonisë)

**Detyrat dhe Përgjegjësitë:**

- Ofron asistencë në kryerjen e punëve administrative për nevojat e punëve të Komisioneve të Përhershme të OMK-së;
- Pranon aplikacionet, kërkesat/ankesat nga palët drejtuar Komisioneve të Përhershme, kujdeset për mbarevajtjen e procedurës administrative deri në shqyrtimin final të lëndës;
- Mirëmbanë dosjet, në formën fizike dhe elektronike si dhe data bazën e Komisioneve të Përhershme;
- Siguron materialet e nevojshme për mbarevajtje të mbledhjeve të Komisioneve të Përhershme;
- Ndhmon anëtarët e Komisioneve në kontaktet me organet e tjera të OMK-së si dhe palëve të treta;
- Kryen edhe punë tjera nga fusha e përgjegjësisë dhe specifikimeve të përcaktuara me Kontratën e Punës.

**Shkollimi i kërkuar:** Të ketë të kryer shkollën e mesme (shkollë profesionale), përparësi konsiderohet shkollimi superior;

**Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:**

- Dy vite përvojë pune në administratë.
- Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës;
- Njohje e mirë e punës me kompjuter Word, Excel, Internet dhe mjeteve tjera teknike në zyrë, fotokopjuesi;
- Shkathësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, për të dhënë udhëzime dhe për të përcjellë informata tek të tjerët;
- Të jetë energjik, të ketë iniciativë dhe kreativitet duke ofruar ide të reja në çështje të ndryshme lidhur me procesin e punës;
- Të jetë fleksibil dhe t'u përgjigjet pozitivisht ndryshimeve;
- Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi;

**Paraqitja e kërkesave:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e kërkuar dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave. Formularët për aplikim mund të shkarkohen nga ueb faqja e OMK-së, [www.omk-rks.org](http://www.omk-rks.org) dhe të gjitha aplikacionet e plotësuar së bashku me kopjen e letërnjoftimit, kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat si dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit, mund të dorëzohen:

- Përmes e-mail adresës [info@omk-rks.org](mailto:info@omk-rks.org) apo
- Përmes postës në adresën "Instituti A" QKUK, kati II, 10 000 Prishtinë, RKS

Në subjekt të emailit të ceket pozita për të cilën aplikoni dhe emri, mbiemri juaj!

Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit dhe do të jetë i hapur nga data: 07.07.2020 deri më 20.07.2020, ora 16:00.

Për informata shtesë mund të kontaktoni në numrat e telefonit: 049/872-300 apo 038 / 544-872.

Konkursi dhe aplikacioni për punësim janë të publikuara edhe në Ueb-Faqen e Odës: <https://omk-rks.org/>

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Orange Group ks" Sh.p.k Veternik, Lagjja Nic, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

**DEBAT PUBLIK**

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për pompën e derivateve në Sllatinë të Madhe, Fushë Kosovë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 28.07.2020 në ora 10:00 në hapësirat e restorant "Holiday Restort" në Sllatinë të Madhe komuna e Fushë Kosovës do të organizohet debat publik nga kompania "Orange Group ks" Sh.p.k Veternik, Lagjja Nic, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për pompën e derivateve në Sllatinë të Madhe, Fushë Kosovë.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Orange Group ks" Sh.p.k Veternik, Lagjja Nic, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

**DEBAT PUBLIK**

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për pompën e derivateve në Harilaq, Fushë Kosovë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 28.07.2020 në ora 10:30 në hapësirat e restorant "Holiday Restort" në Sllatinë të Madhe komuna e Fushë Kosovës do të organizohet debat publik nga kompania "Orange Group ks" Sh.p.k Veternik, Lagjja Nic, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për pompën e derivateve në Harilaq, Fushë Kosovë.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.